



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 50

Tiranë – E mërkurë, 20 mars 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 21/2024, datë 22.2.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”..... 5569
Dekret i Presidentit nr. 110, datë 18.3.2024	Për shpallje ligji..... 5575
Dekret i Presidentit nr. 100, datë 12.3.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 5575
Dekret i Presidentit nr. 101, datë 12.3.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 5575
Dekret i Presidentit nr. 102, datë 12.3.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 5575
Dekret i Presidentit nr. 103, datë 12.3.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 5576
Dekret i Presidentit nr. 104, datë 12.3.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 5576
Dekret i Presidentit nr. 105, datë 12.3.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 5576
Dekret i Presidentit nr. 106, datë 12.3.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 5577
Dekret i Presidentit nr. 107, datë 12.3.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 5577
Dekret i Presidentit nr. 108, datë 12.3.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 5577

Dekret i Presidentit nr. 109, datë 12.3.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	5578
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 96, datë 8.3.2024	Për njoftimin e fillimit të procedurës së përzgjedhjes së anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit...	5578
Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 154, datë 4.3.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin Ukrainës.....	5581
Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 155, datë 4.3.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Bullgarisë....	5584
Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 156, datë 4.3.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Norvegjisë..	5585
Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 157, datë 4.3.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Moldavisë....	5585
Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 158, datë 4.3.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Maqedonisë së Veriut.....	5586
Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 159, datë 4.3.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë.....	5589
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 31.1.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1595, datë 6.12.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, me tjetër trup gjykues, pasi kthimi përsëri në Gjykatën e Lartë vlerësohet si joefektiv për zgjidhjen e kësaj çështjeje në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	5591
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 6, datë 15.2.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 41-2022-3777 (53 prot.), datë 14.12.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	5606
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 7, datë 20.2.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-342 (52), datë 13.2.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	5615

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 15, datë 8.3.2024	Me objekt korrigjim në vendimin nr. 46, datë 3.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese, të gabimit të shtypit të emrit për subjektin e shpronësuar E.D., në pikën 40 të tij, dhe shkrimin e plotë të emrave të subjekteve kërkuese në pikën 1 të vendimit.....	5622
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 3941, datë 13.3.2024	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje dypalëshe me Republikën e Bullgarisë.....	5624
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 7, datë 7.3.2024	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	5625



LIGJ
Nr. 21/2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 81/2017,
“PËR ZONAT E MBROJTURA”

Në mbështetje të neneve 78, 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

“6/1. “Elemente tekniko-formale të shpalljes së zonës së mbrojtur” janë emërtimi i zonës së mbrojtur, institucioni menaxhues, zonimi dhe nënzonimi, si dhe tipologjia e veprimtarive të lejuara dhe të ndaluara për zonën e mbrojtur ose secilën nënzonë të saj kur aplikohet.”.

2. Pas pikës 25 shtohet pika 25/1 me këtë përmbajtje:

“25/1. “Turizëm i ekselencës” në kuptim të këtij ligji është lloji i turizmit, i cili ofron akomodim në struktura me standardet më të larta arkitektonike e mjedisore, si dhe shërbime turistike ekskluzive të nivelit më të lartë.”.

3. Në pikën 36 pas fjalës “tradicionale” shtohen fjalët “ekonomike dhe turistike, duke përputhur objektivin e mbrojtjes, efektivitetit dhe përshtatshmërisë, me veçoritë që paraqet zona e mbrojtur ose nënzona”.

4. Pas pikës 37 shtohen pikat 38 dhe 39 me këtë përmbajtje:

“38. “Zonë natyrore e pashqetësuar” është zona në të cilën garantohen elementet thelbësore të biodiversitetit, ekosistemeve, specieve dhe karakteristikat e gjeodiversitetit të zonës, në një gjendje natyrore ku veprimtaria njerëzore është në harmoni me elementet e natyrës, në mënyrë që zona të vijojë të ruajë karakteristikat e saj.

39. “Zonë natyrore pak e shqetësuar” është zona në të cilën garantohen elementet thelbësore të biodiversitetit, ekosistemeve, ku veprimtaria njerëzore projektohet dhe zhvillohet me elemente dhe/ose struktura të tilla që krijojnë harmoni me elementet e natyrës, në mënyrë që zona të vijojë të shfaqë karakteristikat e saj dhe të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm.”.

Neni 2

Në nenin 4 pas shkronjës “ç” shtohen shkronjat: “d”, “dh” dhe “e” me këtë përmbajtje:

“d) “Parimi i përshtatshmërisë”. Kategoria e një zone të mbrojtur duhet të ndryshohet nëse nga vlerësimi i saj në një kohë të dhënë rezulton se karakteristikat dhe objektivat për të cilat zona e mbrojtur është shpallur nuk përputhen me ato të kategorisë së caktuar.

dh) “Parimi i kategorizimit sipas objektivave”. Përcaktimi i kategorisë së zonës së mbrojtur sipas këtij ligji duhet të kryhet në përputhje me objektivat kryesorë të shpalljes të secilës kategori të zonave të mbrojtura.

e) “Parimi i fleksibilitetit të menaxhimit”. Zonat e mbrojtura menaxhohen sipas çdo forme menaxhimi/administrimi, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.”.

Neni 3

Në nenin 9 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën “c” fjala “moslejimit” zëvendësohet me fjalën “kufizimit”.

2. Shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) të ruajë hapësirën e shpallur zonë e mbrojtur dhe përbërësit natyrorë të saj, me qëllimin për të siguruar vazhdimësinë dhe jetëgjatësinë e elementeve të biodiversitetit, duke përdorur strategji menaxhimi të përshtatshme dhe menaxhim efektiv në kohë.”.

3. Shkronja “d” ndryshohet si më poshtë:

“d) të vlerësojë në përputhje me parimet e objektivave të shpalljes së zonës së mbrojtur mundësinë për veprimtari ekonomike turistike dhe infrastrukturë mbështetëse për to brenda zonës dhe nevojat e komunitetit”.

Neni 4

Në nenin 10 bëhen ndryshimet e mëposhtme:



1. Pika 1 shfuqizohet.

2. Në pikën 3 pas togfjalëshit “së nënzonave të zonës së mbrojtur” shtohen fjalët “si dhe tipologjia e veprimtarive të lejuara dhe të ndaluara për zonën ose secilën nënzonë të zonës që do të shpallet, si dhe përdorimi i të ardhurave që krijohen”.

3. Në pikën 6 bëhen këto ndryshime:

a) shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) një raport i efekteve në mjedis duke përfshirë proceset dhe veprimtaritë e lejuara”.

b) shkronjat “d” dhe “dh” shfuqizohen.

Neni 5

Në nenin 12 pika 2 shfuqizohet.

Neni 6

Neni 13 shfuqizohet.

Neni 7

Në nenin 16 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

a) Pjesa hyrëse ndryshohet si më poshtë:

“Në “Parkun kombëtar”, me përjashtim të infrastrukturës dhe veprimtarive të mikpritjes, me standardet më të larta arkitektonike dhe mjedisore për mbështetjen e turizmit të ekselencës (me 5 yje) dhe infrastrukturës mbështetëse për to, sipas parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji, zbatohet shkalla e mbrojtjes mjedisore të zonës që ka si objektiv të mbajë territorin në gjendje natyrore, ku të ruhen komunitetet biotike, të resurseve gjenetike dhe llojeve për të siguruar stabilitetin ekologjik dhe diversitetin dhe ku:”;

b) Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) nuk lejohet shfrytëzimi ose zënia e tokës për asnjë arsye tjetër”;

c) Shkronja “d” shfuqizohet.

2. Në pikën 3 bëhen këto ndryshime:

a) Pjesa hyrëse ndryshohet si më poshtë:

“Në këtë zonë mund të ushtrohen veprimtari të lejuara të përcaktuara në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur, si dhe ato të parashikuara në nenin 33 të këtij ligji, që sigurojnë krijimin e mundësive shpirtërore, shkencore, edukative, çlodhëse të vizitorëve, në përputhje me kërkesat

mjedisore, kulturore, por vetëm pasi të pajisen me miratimin e institucioneve shtetërore, që synojnë:”.

b) Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) dhënie e kontributit në ekonominë vendase nëpërmjet veprimtarive të turizmit/agroturizmit.”.

3. Në pikën 4 pas togfjalëshit “ruajtjes së zonës” shtohen fjalët “nëse nuk përcaktohen si veprimtari të lejuara apo në mbështetje të këtyre veprimtarive”.

4. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Kur administrata e ruajtjes së parkut vëren se nga veprimtaritë e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni cenohet qëllimi për të cilin zona është shpallur “Park kombëtar”, mund të kufizojë ose të ndalojë përkohësisht këto veprimtari dhe të kërkojë nga AKZM-ja miratimin përfundimtar të kufizimit ose ndalimit të këtyre veprimtarive.”.

5. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Këshilli Kombëtar i Territorit, në shqyrtimin e kërkesave specifike për leje zhvillimi/ndërtimi, me rregullore të posaçme miraton rregullat dhe kriteret teknike të zhvillimit të infrastrukturës kryesore dhe asaj mbështetëse të veprimtarive të lejuara.”.

Neni 8

Në nenin 17 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 2 fjalia e parë shfuqizohet.

2. Pika 3 shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 19 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalës “edukative ” shtohen fjalët “turistike dhe agroturistike”.

2. Në pikën 3, pas togfjalëshit “në parkun natyror” shtohen fjalët “me përjashtim të veprimtarive dhe infrastrukturës turistike dhe infrastrukturës mbështetëse për to, sipas parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji”.

3. Në pikën 4, pas togfjalëshit “administratës së zonës së mbrojtur” shtohen fjalët “nëse janë të ndryshme nga veprimtaritë e lejuara të përcaktuara në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur apo ato të përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji”.

4. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Këshilli Kombëtar i Territorit, në shqyrtimin e kërkesave specifike për leje zhvillimi/ndërtimi, me rregullore të posaçme miraton rregullat dhe kriteret



teknike të infrastrukturës kryesore dhe asaj mbështetëse të veprimtarive të lejuara.”

Neni 10

Në nenin 20 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 1 pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Kategoria e peizazhit të mbrojtur krijon mundësi për zhvillime bashkëkohore si veprimtari turistike/agroturistike apo veprimtari të tjera ekonomike të qëndrueshme, miqësore me biodiversitetin.”

2. Në pikën 2, pas fjalëve “çlodhje dhe argëtim” shtohen fjalët “turizëm/agroturizëm”.

3. Në pikën 3, bëhen këto ndryshime:

a) pas togfjalëshit “peizazh të mbrojtur” shtohen fjalët “në përputhje me rregulloren e posaçme të Këshillit Kombëtar të Territorit”;

b) pas togfjalëshit “zbatohet shkalla” shtohet fjala “e tretë”;

c) në shkronjën “c” togfjalëshi “eliminimin, kur është e domosdoshme, dhe parandalimin” zëvendësohet me fjalën “kufizimin”;

ç) pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) lejin e ndërhyrjeve të lejuara urbane, rekreacioni apo ekonomike brenda zonës, duke ruajtur karakterin e zonës sipas parashikimeve të këtij ligji dhe VKM-së së shpalljes së zonës së mbrojtur.”

4. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur caktohen veprimtaritë e lejuara dhe të ndaluara.”

5. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Këshilli Kombëtar i Territorit në shqyrtimin e kërkesave specifike për leje zhvillimi/ndërtimi, me rregullore të posaçme miraton rregullat dhe kriteret teknike të infrastrukturës kryesore dhe asaj mbështetëse të veprimtarive të lejuara.”

Neni 11

Në nenin 22 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 2 pas togfjalëshit “objektivat e mbrojtjes” shtohen fjalët “që përcaktohen në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Në “zonën e mbrojtur detare” ushtrohen veprimtari sipas përcaktimeve të këtij neni, nenit 33, nenit 34, si dhe VKM-së për shpalljen e zonës së mbrojtur.”

3. Në pikën 3 bëhen këto ndryshime:

a) pas togfjalëshit “në këto zona” shtohen fjalët “me përjashtim të veprimtarive dhe infrastrukturës turistike dhe infrastrukturës mbështetëse për to, sipas parashikimeve në VKM-në e shpalljes së zonës dhe/ose nenin 33 të këtij ligji”;

b) shkronja “ë” ndryshohet si më poshtë:

“ë) tjetërsojnë territorin e habitateve apo të peizazhit me aktivitete minerare apo të shfrytëzimit të gazit e të naftës;”

4. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Këshilli Kombëtar i Territorit në shqyrtimin e kërkesave specifike për leje zhvillimi/ndërtimi, me rregullore të posaçme miraton rregullat dhe kriteret teknike të infrastrukturës kryesore dhe asaj mbështetëse të veprimtarive të lejuara.”

Neni 12

Në nenin 23, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Këshilli Kombëtar i Territorit në shqyrtimin e kërkesave specifike për leje zhvillimi/ndërtimi, me rregullore të posaçme miraton rregullat dhe kriteret teknike të infrastrukturës kryesore dhe asaj mbështetëse të veprimtarive të lejuara.”

Neni 13

Në nenin 24 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 4, fjalët “me urdhër të ministrit dhe u dërgohen për zbatim bashkive menjëherë sapo të miratohet zona e parkut” zëvendësohen me togfjalëshin “urdhër të kryetarit të bashkisë”.

2. Në pikën 5 togfjalëshi “ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura” zëvendësohet me togfjalëshin “kryetari i bashkisë”.

Neni 14

Neni 33 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 33

Veprimtaritë e lejuara në zonat e mbrojtura

Veprimtaritë që lejohen të ushtrohen në zonat e mbrojtura mjedisore janë:



1. Veprimtaritë e përcaktuara në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur dhe të zbatuara sipas kritereve të miratuara me rregullore të posaçme të Këshillit Kombëtar të Territorit.

2. Veprimtaritë e zhvilluara në struktura akomoduese të ekselencës, 5 yje ose më shumë, në fushën e turizmit dhe çdo veprimtari/infrastrukturë tjetër mbështetëse ose në funksion të tyre pavarësisht nëse kjo përcaktohet në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur.

3. Veprimtaritë e zhvilluara në struktura akomoduese të agroturizmit dhe çdo veprimtari/infrastrukturë tjetër mbështetëse ose në funksion të tyre, pavarësisht nëse kjo përcaktohet në vendimin e shpalljes së zonës së mbrojtur.

4. Veprimtaritë me qëllim të monitorimit të gjendjes mjedisore, të ekosistemit, të habitateve dhe të llojeve floristike e faunistike.

5. Çdo veprimtari që lidhet me ndërhyrjet e nevojshme ose urgjente për përmirësimin e biodiversitetit, rigjenerimit ose shëndetësisht, ose çdo veprimtari tjetër për këtë qëllim.

6. Veprimtaritë ushtarake, të cilat mund të ushtrohen pasi të jenë pajisur me leje mjedisore.”

Neni 15

Në nenin 36 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Propozimi për ndryshimin e sipërfaqes së zonës bëhet nga AKZM-ja, ministritë e linjës, njësitë e vetëqeverisjes vendore, nga organe shtetërore kolegjiale që miratojnë projekte dhe veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga institucionet kërkimore-shkencore, shoqëria civile dhe nga pronarët privatë, kur në zonën e mbrojtur janë përfshirë edhe pronat e tyre, si dhe nga subjektet që kryejnë veprimtari në zonë, të pajisur me leje mjedisi. Propozimi konsultohet paraprakisht me komunitetin vendas, me pronarët, pronat e të cilëve, sipas rastit, përfshihen ose hiqen nga sipërfaqja e zonës, me subjektet që ushtrojnë veprimtari brenda zonës, me institucionet shkencore, me organet e qeverisjes vendore ku shtrihet zona dhe argumenton nevojën e ndryshimit.”

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Miratimi i ndryshimit të një apo më shumë elementeve formale të vendimit të shpalljes së zonës

së mbrojtur bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura, ku argumentohet nevoja e ndryshimit konkret pas marrjes së vendimit të KKT-së në rastin e ndryshimit të zonimit dhe nënzonimit.”

Neni 16

Pas nenit 36 shtohet neni 36/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 36/1

Ndryshimi i elementeve tekniko-formale

1. Miratimi i ndryshimit të elementeve tekniko-formale të vendimit të shpalljes së zonës së mbrojtur si emërtimi, institucioni menaxhues, zonimi dhe nënzonimi, si dhe tipologjia e veprimtarive të lejuara dhe të ndaluara për zonën e mbrojtur ose secilën nënzonë të saj bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura, ku argumentohet nevoja e ndryshimit konkret që do të përmirësojë rrjetin dhe mbrojtjen e zonës, pas marrjes së vendimit të KKT-së në rastin e ndryshimit të zonimit dhe nënzonimit.

2. Në rastet e parashikimeve të pikave 2, 3 dhe 4 të nenit 33, miratimi i rregullave dhe kritereve teknike të zhvillimit nga ana e KKT-së konsiderohet akt i ndryshimit.”

Neni 17

Pas nenit 39 shtohet neni 39/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 39/1

Zyra e Administrimit të Parqeve Kombëtare

1. Zyra e Administrimit të Parqeve Kombëtare (ZAPK) është institucion tekniko-administrativ në varësi të ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura, i organizuar në nivel qendror dhe rajonal, e cila ushtron veprimtari brenda territorit gjeografik të zonës së mbrojtur “Park kombëtar”, territori i veprimtarisë së të cilës përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave për krijimin e saj.

2. ZAPK-të brenda territorit të veprimtarisë së tyre ushtrojnë kompetenca administrimi, si dhe miratojnë në koordinim me AKZM-në propozimet



për plane menaxhimi në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

3. Planet e menaxhimit, projektet restauruese dhe konservuese, projektet kërkimore-shkencore të ZAPK-ve shqyrtohen, koordinohen me AKZM-në dhe miratohen nga ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura, në përputhje me natyrën, masën dhe nevojat e zonës së mbrojtur.

4. ZAPK-të kryejnë punime mirëmbajtjeje dhe mund të kryejnë punime me karakter restaurues e konservues në funksion të masave ruajtëse dhe mbrojtëse në zonat e mbrojtura që kanë në administrim.

5. ZAPK-të, në varësi të veçorive natyrore, ambientale, të florës dhe faunës, në tokë dhe në ujëra, bashkëpunojnë dhe koordinojnë me institucionet e fushave përkatëse për ushtrimin e veprimtarive të ndryshme në territorin që administrojnë.

6. ZAPK-të mbikëqyrin efektet mjedisore të çdo ndërhyrjeje apo zhvillimi të propozuar brenda territorit të tyre gjeografik sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

7. ZAPK-të mbajnë lidhje të vazhdueshme dhe informojnë strukturat e qeverisjes qendrore e vendore për zhvillime të karaktereve të ndryshme, që kryhen jashtë territorit të tyre, por që mund të kenë impakt në to.

8. Krijimi i Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar, struktura dhe organika e saj miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura.

9. AdZM-të, pjesë e territorit të të cilave janë parqet kombëtare në të cilat janë krijuar ZAPK-të, përjashtohen nga detyrat për mbrojtjen dhe zhvillimin e këtyre zonave të mbrojtura mjedisore.

10. ZAPK-të brenda territorit të veprimtarisë së tyre ushtrojnë çdo funksion administrimi, menaxhimi që ligji parashikon për AdZM-të.

11. Mënyra e funksionimit, organizimit dhe veprimtarisë së ZAPK-ve përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

12. Struktura dhe organika e tyre miratohet me urdhër të Kryeministrit.”.

Neni 18

Në nenin 40 pas pikës 2 shtohen pikat 2/1 dhe 2/2 me këtë përmbajtje:

“2/1. Gjatë ushtrimit të funksionit të dhënies për përdorim të përkohshëm të territoreve kullota, pjesë e zonës së mbrojtur, AdZM-të apo ZAPK-të lidhin kontratë tripalëshe me bashkinë dhe subjektet e interesuara.

2/2. Bashkia, në përmbajtje të kontratës, përcakton vendndodhjen dhe sipërfaqen e dhënë në përdorim duke e vlerësuar atë në raport me kërkesat e paraqitura nga subjektet e interesuara në momentin e njoftimit për aplikim. Me lidhjen e kontratës tripalëshe, sipas këtij neni, bashkia bëhet përfituese e të ardhurave që vijnë nga përdorimi i përkohshëm i kullotës. Procedura rregullohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura.”.

Neni 19

Në nenin 47 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 pas togfjalëshit “territori i zonës së mbrojtur” shtohet togfjalëshi “për kategoritë “Park kombëtar” dhe “Rezervat natyror i menaxhuar/ Park Natyror”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Zonimi i brendshëm përmban nënzonën qendrore, nënzonën e përdorimit të qëndrueshëm dhe nënzonën e rekreacionit dhe është pjesë e vendimit të Këshillit të Ministrave që shpall zonën e mbrojtur.”.

3. Në pikën 4 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Këshilli Kombëtar i Territorit me rregullore të posaçme përcakton rregullat dhe kriteret teknike të infrastrukturës kryesore dhe asaj mbështetëse për projekte specifike të lidhura me zbatimin e veprimtarive të lejuara në të cilat zbatohen shkalla e parë, e dytë dhe e tretë e mbrojtjes.”.

4. Pika 5 shfuqizohet.

Neni 20

Neni 48 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 48

Nënzona qendrore

1. Në nënzonën qendrore të një zone të mbrojtur mjedisore zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes.

2. Veprimtaritë e ndaluara në nënzonën qendrore të një zone të mbrojtur mjedisore janë:

a) përdorimi i kimikateve dhe i plehrave kimike;

b) nxjerrja e mineraleve dhe e torfave me përjashtim të gurëve dhe rërës për mirëmbajtjen e parkut;



c) ndezja e zjarreve;

ç) gjuetia;

d) neutralizimi i mbetjeve me origjinë jashtë territorit të “Parkut kombëtar”;

dh) shpërndarja e kafshëve dhe e bimëve jovendase, kur ato sjellin ndryshime në biodiversitetin e zonës;

e) riprodhimi intensiv, me përjashtim të riprodhimeve shpëtuese;

ë) ndërtimi i autostradave, hekurudhave, zonave urbane, hidrocentraleve dhe sistemeve të naftës dhe gazit me shtrirje të gjatë;

f) larja dhe spërkatja e rrugëve me kimikate;

g) mbjellja e pyjeve monokulturë;

gj) lëvizja e mjeteve të transportit jashtë rrugëve të caktuara.

3. Veprimtaritë e lejuara në nënzonën qendrore, përveç atyre të përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji, përcaktohen në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur.”.

Neni 21

Në nenin 49 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në titullin e nenit togfjalëshi “tradicional dhe” hiqet.

2. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Në nënzonën e përdorimit të qëndrueshëm të një zone të mbrojtur mjedisore zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, nëse nuk janë në funksion/mbështetje të veprimtarive të lejuara, janë të ndaluara.”.

3. Pas shkronjës “dh” shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Veprimtaritë e lejuara në nënzonën e përdorimit të qëndrueshëm, përveç atyre të përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji, përcaktohen në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur.”.

Neni 22

Në nenin 50 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Në nënzonën e përdorimit të qëndrueshëm dhe të rekreacionit të një zone të mbrojtur mjedisore zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes, nëse nuk janë në funksion/mbështetje të veprimtarive të lejuara, janë të ndaluara.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Veprimtaritë e lejuara në nënzonën rekreative, përveç atyre të përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji, përcaktohen në VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur.”.

Neni 23

Në nenin 56, në pikën 1 pas fjalëve “e parashikuar në” shtohen fjalët “VKM-në e shpalljes së zonës së mbrojtur ose”.

Neni 24

Në nenin 57, në pikën 3 pas togfjalëshit “zonave të mbrojtura administrohen” shtohen fjalët “nga ZAPK-ja ose”.

Neni 25

Kudo në përmbajtjen e neneve 66, 67 dhe 69 fjalët “Inspektorati i Policisë Pyjore/Inspektorët e Policisë Pyjore/Inspektori” zëvendësohen me fjalët “AKZM-ja dhe trupat inspektuese të AdZM-ve rajonale”.

Neni 26

Në nenin 74, pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“4. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave, ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura dhe KKT-të marrin masa të sigurojnë konformitetin e elementeve tekniko- formale të vendimeve të shpalljes së zonave të mbrojtura me parashikimet e këtij ligji.

5. Brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave, ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura miratojnë aktet e nevojshme për shpalljen e zonave të mbrojtura në përputhje me parashikimet e këtij ligji.”.

Neni 27

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 22.2.2024.

Shpallur me dekretin nr. 110, datë 18.3.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

**DEKRET****Nr. 110, datë 18.3.2024****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 21/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017, ‘Për zonat e mbrojtura’”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 100, datë 12.3.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Enoklid Muharrem Bana
2. Leonora Neim Daja
3. Ana Muhamet Qoli (Luzi)
4. Aida Skënder Ahmetaj (Herri)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 101, datë 12.3.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Marseda Muharrem Çangu (Lame)
2. Armina Flogert Çangu
3. Rejan Fatmir Stafa
4. Denisa Ferim Redeker (Hoti)
5. Sonila Ferdinand Serjani
6. Enver Malko Malko
7. Gresi Enver Malko

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 102, datë 12.3.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:



1. Shaban Zenun Memia
2. Gentjan Gani Holstein (Tafani)
3. Eno Shpëtim Dragoj
4. Gertian Petrit Brahimaj
5. Mares Gëzim Kupka (Ahmeti)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 103, datë 12.3.2024

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Raul Kujdes Cibaku
2. Iljaz Bashkim Ibrahim
3. Juljana Fatmir Taho
4. Bledi Shemsedin Çefa

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 104, datë 12.3.2024

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Eleni Nikolla Sidheri
2. Buyamin (Bujamin) Nuredin Kahalliu (Qahalliu)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 105, datë 12.3.2024

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Jorgo Kristofor Sidheri
2. Jolanda Halit Kurti



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 106, datë 12.3.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Andreas (Andrea) Todi Minga

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 107, datë 12.3.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Bledar Genc Zajmi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 108, datë 12.3.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetasas:

1. Almarinda (Almarina) Astrit Shametaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



DEKRET
Nr. 109, datë 12.3.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Besnik Ismail Hoti
2. Guxim Gëzim Efendija
3. Genti Albert Batalli
4. Altin Dugagjin Kabashi
5. Arioneta Hysen Doli (Xharra)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

URDHËR
Nr. 96, datë 8.3.2024

PËR NJOFTIMIN E FILLIMIT TË
PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES SË
ANËTARIT TË BORDIT TË
ADMINISTRIMIT, PËRFAQËSUES I
MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR
ARSIMIN, NË UNIVERSITETIN “EQREM
ÇABEJ”, GJIROKASTËR, MËNYRËN E
VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE
AFATIN E DORËZIMIT TË
DOKUMENTACIONIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 48, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të pikës 7, të

vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”,

URDHËROJ:

1. Njoftimin e fillimit të procedurës së përzgjedhjes së anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Përzgjedhja e kandidatit për anëtar të Bordit të Administrimit të kryhet në përputhje me kriteret, procedurën dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave dhe shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët për anëtar të Bordit të Administrimit, do të jetë deri në datë 25.3.2024.

4. Publikimi i kriterëve dhe procedurave që do të ndiqen për konkurrimin, për pozicionin e anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin, “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, të bëhet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

5. Lista e kandidatëve të përzgjedhur publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin: www.arsimi.gov.al.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ogerta Manastirliu



SHTOJCA NR. 1

**NJOFTIM
PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARIT TË
BORDIT TË ADMINISTRIMIT,
PËRFAQËSUES I MINISTRISË
PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN, NË
UNIVERSITETIN “EQREM ÇABEJ”,
GJIROKASTËR**

Në zbatim të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe urdhrin nr. 96, datë 8.3.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarit të Bordit të Administrimit, përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpall njoftimin për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarit të Bordit të Administrimit në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, si më poshtë:

Nr.	Institucioni publik i arsimit të lartë	Numri i anëtarëve për Bord Administrimi
1.	Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë	- 1 anëtarë përfaqësues i MAS-it

1. Përshkrim i përgjithshëm

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegial administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Bordi i Administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Anëtarët, përfaqësues të IAL-së, përzgjidhen nga Senati Akademik i IAL-së për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, prej listave të propozuara nga institucioni i arsimit të lartë. Në listën e kandidatëve jepen të dhënat e individëve që vetëkandidojnë apo propozohen nga njësitë bazë të institucionit të arsimit të lartë apo institucioneve përkatëse. Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe njësisë së qeverisjes vendore janë

ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike dhe emërohen përkatësisht nga ministri përgjegjës për arsimin dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë.

2. Kompetencat dhe funksionet e Bordit të Administrimit

Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:

- garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;
- vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
- miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njërive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;
- jep mendim për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
- përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
- është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;
- emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;
- miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;
- miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati.

3. Kërkesat e pranimit**a) Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati**

- të jetë shtetas shqiptar;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;



- të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike;

- të ketë integritet etik dhe profesional;
- të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;

- të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë;

- të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati

- të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë;

- të jetë i padënuar ose ndaj tij të mos jenë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jo përfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar;

- të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

- të mos ketë ndaj tij masë disiplinore në fuqi;
- të njohë të paktën një gjuhë të huaj;
- të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup;

- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.

4. Lista e dokumentacionit, vendi dhe afati i dorëzimit

- kërkesë për aplikim;
- jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (*CV - Curriculum Vitae*);

- fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën *Bachelor*). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet Vërtetimi i Njohjes dhe Njehsimit të Diplomës/Certifikatës, të lëshuara nga strukturat përgjegjëse përkatëse;

- fotokopje të librezës së punës;
- vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj;

- formular i vetëdeklarimit i gjendjes gjyqësore;

- vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake, sipas formatit të shtojcës nr. 1/1;

- vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit, sipas formatit të shtojcës nr. 1/2;

- vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 1/3;

- vetëdeklarim se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

5. Paraqitja e dokumenteve të cituara më sipër, do të jetë deri në datën 25.3.2024 në një nga këto mënyra:

- a) me postë zyrtare në adresë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

- b) dorëzimi dorazi në ambientet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Dokumentacioni i paraqitur nga kandidatët administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, e cila vë në dispozicion të Komisionit *Ad Hoc* të ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

6. Mënyra dhe koha kur do të shpallet lista e kandidatëve të përzgjedhur

- Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të bordit të administrimit kryhet nga një komision *Ad Hoc* i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, i cili shqyrton dokumentacionin e paraqitur brenda 10 ditëve pune, nga data e përfundimit të afatit të aplikimit dhe harton listën e kandidatëve të kualifikuar, që plotësojnë kriteret ligjore.

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Ministria e Arsimit dhe Sportit do të shpallë kandidatin e përzgjedhur në faqen e saj zyrtare: www.arsimi.gov.al.

7. Masa e shpërblimit

Bazuar në VKM-në nr. 656, datë 31.10.2018, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përherëshme të njësive të qeverisjes qendrore”, i ndryshuar, kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në bordin e administrimit në institucionet e arsimit të lartë publik është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.



SHTOJCA NR. 1/1

VETËDEKLARIM MBI MOSANGAZHIMIN
NË FUNKSIONE DREJTUESE PARTIAKE

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____,
që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi
Administrimi në institucionin publik të arsimit të
lartë, deklaroj se _____ i angazhuar në
funksione drejtuese partiake.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën
e deklarimit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/2

VETËDEKLARIM MBI KONFLIKTIN E
INTERESIT

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____,
që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi
Administrimi në institucionin publik të arsimit të
lartë, deklaroj se _____ në kushtet e konfliktit
të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005.
“Për parandalimin e konfliktit të interesave në
ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe
legjislacioni në fuqi, për të ushtruar këtë detyrë.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën
e deklarimit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/3

VETËDEKLARIM PËR VERIFIKIMIN E
VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË
PARAQITURA NGA KANDIDATI

Unë, i nënshkruari _____,
kandidat në procesin e konkurrimit për anëtar bordi
në institucionin publik të arsimit të lartë, autorizoj
Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të verifikojë në çdo
kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga
ana ime.

Datë _____

Nënshkrimi _____

URDHËR

Nr. 154, datë 4.3.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN UKRAINËS

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës,
në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për
shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të
ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në
territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha
kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër,
produkteve të tyre, materialit biologjik dhe
embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra,
mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të
kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga
faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-ës, përkatësisht
nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën
e mëposhtme:

Ndarja Administrative e Nivelit 1	Ndarja Administrative e Nivelit 2	Ndarja Administrative e Nivelit 3
Chernihiv	Ripkyns'kyi*	
Chernihiv	Nizhyns'kyi*	
Chernihiv	Kozelets'kyi*	
Chernihiv	Pryluts'kyi*	
Chernihiv	Nosivs'kyi	
Chernivtsi	Hlybots'kyi*	
Chernivtsi	Zastavnets'kyi*	
Kharkiv	Krasnokuts'kyi*	
Kiev	Obukhivs'kyi*	



Kiev	Vyshhorods'kyi*	
Kiev	Boryspil's'ka*	
Kiev	Ivankivs'kyi*	
Kiev	Holosiivs'kyi*	
Kiev	Pereiaslav-Khmel'nyts'kyi*	
Kiev	Bilotserkivs'kyi*	
Kirovohrad	Kirovohrads'kyi*	
Kirovohrad	Novoukrans'ky*	
Kirovohrad	Svitlovods'kyi*	
Zhytomyr	Zhytomyrs'ka*	
Kherson	Beryslavs'kyi*	
Donets'k	Oleksandrivs'kyi*	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Ukrainës, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8.

2.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajes afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë

reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose në nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;



ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur, në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4. Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që: a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenin 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit.

a) Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajes afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti.

2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenin 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve

15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajes afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajes afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.



3. Urdhri nr. 109, datë 14.2.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin Ukrainës”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I MINISTRISË SË
BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

URDHËR
Nr. 155, datë 4.3.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E BULLGARISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- shpendëve dekorativë;
- materialit biologjik të shpendëve;

d) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, nga shteti i Bullgarisë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	*Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1	Dobrich	Dobrich-selska*	
2	Dobrich	Dobrich*	
3	Dobrich	General Toshevo*	
4	Pazardzhik	Pazardzhik*	
5	Veliko Tarnovo	Veliko Tarnovo	
6	Haskovo	Haskovo*	
	Haskovo	Dimitrovgrad*	
7	Plovdiv	Brezovo*	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajuara termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 92, datë 13.2.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Bullgarisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.



Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I MINISTRISË SË
BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari**

**URDHËR
Nr. 156, datë 4.3.2024**

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E NORVEGJISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

- Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:
 - shpendëve të gjallë shtëpiakë;
 - zogjve 24-orësh;
 - shpendëve dekorativë;
 - materialit biologjik të shpendëve;
 - vezëve të shpendëve;
 - mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
 - nënprodukteve të shpendëve të patrajtuara termikisht, nga shteti i Norvegjisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	*Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1	Rogaland	Lund*	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

- Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve,

për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuara termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I MINISTRISË SË
BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari**

**URDHËR
Nr. 157, datë 4.3.2024**

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E MOLDAVISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

- Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:
 - shpendëve të gjallë shtëpiakë;
 - zogjve 24-orësh;
 - shpendëve dekorativë;
 - materialit biologjik të shpendëve;
 - vezëve të shpendëve;
 - mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
 - nënproduktet e shpendëve të patrajtuara termikisht, nga shteti i Moldavisë, sipas tabelës së mëposhtme:



Nr.	*Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1	Făleşti*		
2	Telenesti*		
3	Floreşti*		
4	Drochia*		
5	Ştefan Voda*		
6	Reşina*		
7	Şoldăneşti*		
8	Soroca*		
9	Râşcani*		
10	Dubăsari*		
11	Edineţ		
12	Glodeni*		
13	Străşeni*		
14	Cahul*		
15	Orhei*		

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuara termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 95, datë 13.2.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Moldavisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I MINISTRISË SË
BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

URDHËR
Nr. 158, datë 4.3.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E MAQEDONISË SË VERIUT**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-së, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja Administrative e Nivelit 1	Ndarja Administrative e Nivelit 2*	Ndarja Administrative e Nivelit 3
Češinovo-Obleševo	Ularci*	
Delcevo*		
Karbinci	Karbinci*	
Kočani*		
Kratovo*		
Gostivar*		
Gradsko*		
Kriva Palanka*		
Kumanovo	Kumanovo*	
Kumanovo	Dolno Konjare*	
Kumanovo	Ljubodrag*	
Kumanovo	Tabanovce*	
Kumanovo	Recica*	



Makedonska Kamenica*		
Novo Selo	Novo Selo	
Probištip	Drenok*	
Probištip	Shtalkovica*	
Probištip	Stalkovica*	
Rankovce*		
Staro Nagoričane	Staro Nagoričane*	
Staro Nagoričane	Arbanasko*	
Staro Nagoričane	Tromegja*	
Štip	Štip*	
Vinitsa	Vinitsa*	
Vinitsa	Vinicka Krshla*	
Vrapčište*		
Novatsi*		
Kavadartsi*		
Pehčevo*		
Zajas*		
Makedonski Brod*		
Vraneštica*		
Časka*		
Oslomej*		
Drugovo*		
Berovo*		
Debarca*		
Dolneni*		
Veles*		
Gevgelija*		
Radoviš*		
Vevčani*		
Tetovo*		
Bosilovo*		
Negotino*		
Ilinden*		
Struga*		

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Maqedonisë së Veriut të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tri muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajes afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11, të Kodit Terrestrial të OIE-së sipas rastit.



2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10, të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajes afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të nenëve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajes afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:



a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave; në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 130, datë 22.2.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Maqedonisë së Veriut”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I MINISTRISË SË
BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Arian Jaupllari

URDHËR

Nr. 159, datë 4.3.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E ITALISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24 orësh;

c) shpendëve dekorativë;

ç) materialit biologjik të shpendëve;

d) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, nga shteti i Italisë, sipas tabelës së mëposhtme:

N r.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	*Ndarja administrative e nivelit 3
1	Lombardia	Brescia	Isorella
2	Lombardia	Brescia	Pavone Del Mella
3	Lombardia	Brescia	Gottolengo
4	Lombardia	Brescia	Milzano
5	Lombardia	Brescia	Pralboino
6	Lombardia	Brescia	Gambara
7	Lombardia	Brescia	Remedello
8	Lombardia	Brescia	Calvisano
9	Lombardia	Brescia	Pozzolengo
10	Lombardia	Brescia	Cigole
11	Lombardia	Como	Sorico
12	Lombardia	Cremona	Casalmorano
13	Lombardia	Cremona	Grontardo
14	Lombardia	Mantua	Roverbella



15	Lombardia	Mantua	Medole
16	Lombardia	Mantua	Asola
17	Lombardia	Mantua	Goito
18	Lombardia	Mantua	Ceresara
19	Lombardia	Mantua	Volta Mantovana
20	Lombardia	Mantua	Guidizzolo
21	Lombardia	Mantua	Pegognaga
22	Lombardia	Mantua	Acquanegra Sul Chiese
23	Lombardia	Mantua	Piubega
24	Lombardia	Pavia	Arena Po
25	Piemonte	Cuneo	Pianfei
26	Sardegna	Cagliari	Cagliari
27	Toscana	Florence	Scandicci
28	Toscana	Florence	Campi Bisenzio
29	Toscana	Prato	Vernio
30	Toscana	Prato	Montemurlo
31	Veneto	Padua	Lozzo Atestino
32	Veneto	Padua	Santa Margherita d' Adige
33	Veneto	Padua	Ponso
34	Veneto	Padua	Ospedaletto Euganeo
35	Veneto	Padua	Vighizzolo d' Este
36	Veneto	Padua	Casale Di Scodosia
37	Veneto	Padua	Saletto
38	Veneto	Padua	Sant' Urbano
39	Veneto	Padua	Piove Di Sacco
40	Veneto	Rovigo	San Bellino
41	Veneto	Verona	Casaleone
42	Veneto	Verona	Isola Della Scala
43	Veneto	Verona	San Bonifacio
44	Veneto	Verona	Verona
45	Veneto	Verona	San Giovanni Lupatoto
46	Veneto	Verona	Erbè
47	Veneto	Verona	Buttapietra
48	Veneto	Verona	Salizzole
49	Veneto	Verona	Bovolone
50	Veneto	Verona	Zimella
51	Veneto	Verona	Pescantina
52	Veneto	Verona	Cologna Veneta
53	Veneto	Verona	Veronella
54	Veneto	Verona	Roverchiara
55	Veneto	Verona	Bonavigo

56	Veneto	Verona	Pressana
57	Veneto	Verona	Isola Rizza
58	Veneto	Verona	Cerea
59	Veneto	Verona	Terrazzo
60	Veneto	Verona	Albaredo d' Adige
61	Veneto	Verona	Cazzano Di Tramigna
62	Veneto	Verona	Illasi
63	Veneto	Verona	Oppeano
64	Veneto	Verona	Trevenzuolo
65	Veneto	Vicenza	Villaga
66	Veneto	Vicenza	Noventa Vicentina
67	Veneto	Vicenza	Montegalda
68	Veneto	Vicenza	Castegnero
69	Veneto	Vicenza	Albettone
70	Veneto	Vicenza	Sossano
71	Veneto	Vicenza	Orgiano
72	Veneto	Vicenza	Campiglia Dei Berici
73	Veneto	Vicenza	Longare
74	Veneto	Vicenza	Camisano Vicentino
75	Veneto	Vicenza	Pojana Maggiore
76	Emilia-Romagna	Bologna	Crevalcore
77	Apulia	Lecce	Lecce

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajuara termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 782, datë 29.12.2023, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së



Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I MINISTRISË SË
BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Arian Jaupllari

VENDIM
Nr. 4, datë 31.1.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Illir Toska	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Genti Ibrahim	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 31.1.2024,
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të
dokumenteve çështjen nr. 8 (F) 2023 të Regjistrit
Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Florjan Gega, përfaqësuar nga
avokat Jordan Daci, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i
Republikës së Shqipërisë, në mungesë; Këshilli i
Ministrave; Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar
nga prokurori Arqilea Koça, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-
1595, datë 6.12.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës
së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e
Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e
Rrethit Gjyqësor Fier, me tjetër trup gjykues, pasi
kthimi përsëri në Gjykatën e Lartë vlerësohet si
joefektiv për zgjidhjen e kësaj çështjeje në përputhje
me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 5, 13, 17, 18, 33, 42,
43, 54, 116, 122, 123, 131, pika 1, shkronja “P”, 134,
pikat 1, shkronja “I” dhe 142 të Kushtetutës së

Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 6, 13 dhe 14, të
Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
(KEDNJ); neni 2 i Protokollit Shtesë nr. 7 dhe
Protokollit Shtesë nr. 12 i KEDNJ-së; nenet 49, pika
3, shkronja “e”, 71 dhe 71/a, të ligjit nr. 8577, datë
10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e
Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,
të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Këshillin të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe Prokurorisë së Përgjithshme, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (Kuvendit), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I Rrethanat e çështjes

1. Në vitin 2018 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar procedimin penal nr. 2078, në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin Florjan Gega (kërkuari), duke e akuzuar atë për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana cilësuese”, të parashikuar nga neni 79/1, shkronja “a”, i Kodit Penal (KP), ndaj shtetasit të mitur D.V. Ai është arrestuar pas kryerjes së krimit, duke u caktuar dhe zbatuar ndaj tij masa e sigurimit “Arresti në burg”. Në përfundim të hetimeve paraprake prokurori ka depozituar kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, në kuadër të shqyrtimit të së cilës, gjyqtari i seancës paraprake në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur mospranimin e kërkesës së mbrojtësit të kërkuarit për gjykim të shkurtuar, me arsyetimin se neni 403/2 i Kodit të Procedurës Penale (KPP) ndalon gjykimin e shkurtuar për veprat penale si ajo e nenit 79/1, shkronja “a”, të KP-së, për të cilat parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm. Ai, gjithashtu, ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq. Çështja është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe kërkuari nuk ka pranuar të marrë pjesë në gjykim,



por është mbrojtur rregullisht me avokat të zgjedhur.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, pasi ka proceduar me gjykim të zakonshëm, me vendimin nr. 464, datë 29.12.2020, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuarit për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuar nga neni 79, shkronja “a”, i KP-së dhe dënimin e tij me 12 vjet burgim, me arsyetimin se nga çmuarja në tërësi e provave të shqyrtuara në seancë gjyqësore ka rezultuar e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuari ka kryer vrasjen e të miturit D.V. Kundër këtij vendimi mbrojtësi i kërkuarit ka paraqitur ankim në lidhje me masën e dënimit, duke kërkuar caktimin e një dënimi më të lehtë. Po ashtu, krahas vendimit përfundimtar, ai ka ankimuar edhe vendimin për refuzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, duke kërkuar pranimin e saj.

3. Gjykata e Apelit Vlorë, pasi e ka shqyrtuar çështjen në prani të mbrojtësit të kërkuarit dhe në mungesë të vullnetshme të këtij të fundit, me vendimin nr. 112, datë 6.5.2021, ka vendosur lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me arsyetimin se përfundimi i arritur nga ajo është i drejtë për sa i përket fajësisë, cilësimit ligjor të veprës penale, llojit dhe masës së dënimit të caktuar ndaj kërkuarit. Kjo gjykatë i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet e ngritura nga ky i fundit në lidhje me refuzimin e gjykimit të shkurtuar dhe për sa i përket uljes së masës së dënimit. Kundër këtij vendimi, mbrojtësi i kërkuarit ka ushtruar rekurs, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe më parë dhe ka kërkuar prishjen e tij, sikundër edhe të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim pranë kësaj të fundit.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1595, datë 6.12.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432/1 të KPP-së.

5. Në vijim, kërkuari ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), i cili është regjistruar në datën 30.3.2023, me objekt shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë si të papajtueshëm me Kushtetutën. Po kështu, në përmbajtjen e ankimit ai ka kërkuar edhe shfuqizimin e neneve 436, pika 2 dhe 437 të KPP-së, si të papajtueshme me Kushtetutën.

6. Me vendimin e datës 13.5.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve, ndërsa kjo e fundit, me vendimin e datës 26.6.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuari**, në mënyrë të përmblëdhur, ka pretenduar se:

7.1 *Nga procesi gjyqësor*, i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, në drejtëm të:

7.1.1 *Parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier nuk ka qenë kompetente për hetimin e çështjes, e cila është regjistruar në këtë prokurori në datën 19.10.2018, ndërkohë që në fuqi ishte Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 6218, datë 7.7.2009, sipas të cilit seksioni penal për gjykimin e të miturve do të krijohej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Edhe kjo e fundit, ku është zhvilluar seanca paraprake në datën 6.6.2019, nuk ka qenë kompetente për shqyrtimin e kërkesës së prokurorit për gjykim, pasi 6 ditë përpara ishte miratuar udhëzimi nr. 79, datë 30.5.2019, i Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas të cilit në çdo gjykatë duhet të caktoheshin së paku tre gjyqtarë për gjykimin e çështjeve për të mitur dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk e plotësonte këtë kusht ditën e zhvillimit të seancës paraprake.

7.1.2 *Së drejtës së aksesit në gjykatë*, pasi data dhe ora e gjykimit në dhomën e këshillimit në Gjykatën e Lartë nuk janë shpallur as në këndin e njoftimeve, as në faqen zyrtare të saj, ndërkohë që kërkuari gjendej në burg në kohën e gjykimit të çështjes. Mbrojtësi i kërkuarit nuk është njoftuar me *e-mail*, ndonëse adresat e *e-mail-it* ishin dhënë në rekurs, në kërkesën për përsheptimin e gjykimit, si edhe në shkresën “Vënie në dijeni për përfaqësim”. Në bazë të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), njoftimi vetëm me shpallje publike nga Gjykata e Lartë dhe jo me anë të njoftimit personal është cilësuar në kundërshtim me nenin 42 dhe 43 të Kushtetutës. Rekursi është shqyrtuar në dhomën e këshillimit dhe jo në seancë gjyqësore, megjithëse përmbante një kërkesë për unifikim të praktikës gjyqësore, sipas nenit 438 të KPP-së. Kërkuari ka qenë në pamundësi për të paraqitur ankime kundër vendimit për revokimin e



seancës sipas neneve 407 dhe 415 të KPP-së. Po kështu, në kundërshtim me nenin 18 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (KDPM), psikologu nuk ka qenë i pranishëm as në seancën paraprake, as gjatë gjykimit të çështjes në themel.

7.1.3 *Së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi kërkuesi nuk ka qenë i pranishëm në asnjë fazë të gjykimit të çështjes penale. Ndonëse gjykatat e faktit kanë referuar si rrethanë rënduese faktin që vepra penale është kryer për motive të dobëta, as ato, as kërkesa e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjykim nuk e përmbajnë këtë specifikim. Ky fakt ka pamundësuar mbrojtjen e tij, në lidhje me rrethanën rënduese.

7.1.4 *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe të paanshme*, pasi në fashikullin e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë mungon vendimi për caktimin e datës së gjykimit të çështjes në dhomën e këshillimit. Data e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit rezulton vetëm në aktin e kalimit të çështjes gjyqësore gjyqtarit të caktuar dhe në listën e çështjeve penale për shqyrtim në dhomën e këshillimit, të shpallur në datën 2.11.2022. Në rastin objekt shqyrtimi, akti i caktimit të gjyqtarit përmban edhe datën e zhvillimit të gjykimit në dhomën e këshillimit, që nuk e ka caktuar vetë trupi gjykues me ndonjë vendim, që do të thotë se caktimi i çështjes ose hedhja me short mund të jetë bërë pasi fashikulli i ka kaluar në mënyrë të paligjshme gjyqtarit relator dhe është bërë vetëm për të plotësuar këtë mangësi që ka pasur ky rast. Ndërkohë që është po kaq e parregullt marrja e një fashikulli nga gjyqtari pa u caktuar me short për atë çështje.

7.1.5 *Parimit për gjykim të drejtë*, pasi në fashikullin e Gjykatës së Lartë mungon regjistrimi audio i gjykimit në dhomën e këshillimit të çështjes në ngarkim të tij, sipas udhëzimit nr. 353, datë 3.9.2013, të ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio” (*udhëzimi nr. 353/2013 i ministrit të Drejtësisë*), si dhe neneve 115 dhe 177 të KPP-së. Po kështu, procesverbali i dhomës së këshillimit nuk përmban elementet e kërkuara nga neni 115 i KPP-së dhe mungon në tërësi transparencë e procesit, fakte këto që krijojnë dyshime për paanësinë e gjykatës.

7.1.6 *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar e nuk jep asnjë përgjigje për konstatimet që parashtrohen

nga këshilltari dhe relatori i çështjes në relacionin përkatës. Po kështu, ndërmjet relacionit të relatorit/këshilltarit dhe vendimit përfundimtar të Gjykatës së Lartë ka dallime në përmbajtje. Arsytimi i vendimit të kësaj gjykate është i mangët dhe i pambështetur në prova, në ligj dhe në standardet kushtetuese, si dhe gjuha e përdorur dhe analiza ligjore janë të pakuptueshme.

7.1.7 *Parimit të ligjshmërisë*, pasi relatori i çështjes dhe këshilltari ligjor në Gjykatën e Lartë kanë vënë në dyshim zbatimin korrekt të ligjit material me rëndësi për njësimin e praktikës, duke iu referuar edhe një rast të ngjashëm të ardhur në Gjykatën e Lartë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë lidhur me individualizimin e saktë të veprës penale sipas nenit 79 apo 76 të KP-së.

7.2 *Parimi për barazi përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës në lidhje me nenet 6 dhe 7 të KEDNJ-së dhe Protokollin Shtesë 12 të saj, pasi arsyetimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, sipas të cilit konsiderohet rrethanë rënduese fakti se i pandehuri vjen nga një familje me formim nën mesatar, është qartazi një element diskriminues. Kolegji penal i Gjykatës së Lartë ka mbajtur standarde të ndryshme lidhur me gjykimin e shkurtuar. Në vendimin nr. 00-2022-641, datë 12.5.2022, në ngarkim të të miturit A. Xh. në konflikt me ligjin, në të njëjtat rrethana ligjore, ky kolegji e ka vlerësuar të ligjshëm lejimin e gjykimit të shkurtuar për të miturin, mbi të cilin rëndonte akuzë e njëjtë sikurse për kërkuesin.

7.3 *E drejta për të mos u dënuar pa ligj e lidhur me parimin e proporcionalitetit*, të garantuara nga nenet 17 dhe 29, pika 1, të Kushtetutës, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, u janë referuar kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në KPP, ndërkohë që duke qenë i mitur në konflikt me ligjin, ligji i posaçëm e orienton organin procedues që në caktimin e llojit dhe masës së dënimit t'i referohet KDPM-së, që në rastin konkret duhej të prevalonte ndaj KPP-së. Po kështu, gjykatat e faktit nuk kanë zbatuar drejt ligjin lidhur me rrethanat lehtësuese dhe rënduese ndaj kërkuesit.

7.4 *Dispozitat ligjore të kundërshtuara* janë të papajtueshme me Kushtetutën, pasi:

7.4.1 Neni 436 i KPP-së, në lidhje me njoftimin e seancave gjyqësore, nuk është në pajtim me Kushtetutën, pasi kjo e fundit kërkon që njoftimi i të pandehurit të jetë efektiv dhe jo thjesht formal,



ndërkohë që mungesa e njoftimit efektiv rrezikon për të pandehurin humbjen e mundësisë së parashtrimit të mbrojtjes së tij para gjykatës si pjesë e së drejtës kushtetuese për t'u dëgjuar para se të gjykohet.

7.4.2 Neni 437 i KPP-së, në lidhje me shqyrtimin gjyqësor në prani të palëve në Gjykatën e Lartë, nuk garanton të drejtën e të pandehurit që të mbrohet vetë personalisht. Kjo dispozitë është shfuqizuar *de facto* nga Kushtetuta, por ky fakt duhet të konstatohet si i tillë nga Gjykata në kuadër të gjyqimit të këtij ankimi individual.

8. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, në lidhje me kërkimin për shfuqizimin e neneve 436, pika 2 dhe 437 të KPP-së, si të papajtueshme me Kushtetutën, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, megjithëse është njoftuar rregullisht.

9. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, në lidhje me kërkimin për shfuqizimin e neneve 436, pika 2 dhe 437 të KPP-së, si të papajtueshme me Kushtetutën, ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

A) Për legjitimitimin

9.1 Kërkuesi nuk legjitimohet në lidhje me pretendimet për antikushtetutshmërinë e dispozitave ligjore, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion të tij. Këto pretendime para se të ngrihen në Gjykatë, duhet të paraqiten për gjykim në të gjitha gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Po kështu, ai nuk ka ngritur në rekurs asnjë pretendim me natyrë kushtetuese ose në drejtim të kushtetutshmërisë së dispozitave ligjore dhe Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, nuk ka pasur mundësi për të bërë një vlerësim të situatës. Pretendimi i ngritur ndaj nenit 437, pika 3, të KPP-së përbën gjë të gjykuar, pasi kjo dispozitë është bërë edhe më parë objekt shqyrtimi në Gjykatë, e cila me vendimin nr. 25/2023 ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

B) Për themelin

9.2 Pretendimi për shfuqizimin e nenit 436, pika 3, është i pabazuar dhe në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës dhe atë të GJEDNJ-së, pasi sipas kësaj dispozite mbrojtësit i vihen në dispozicion 3 mënyra efektive informimi për marrjen dijeni për procesin që zhvillohet në Gjykatën e Lartë, përmes: 1. njoftimit nëpërmjet afishimit; 2. njoftimit në faqen zyrtare të saj; si dhe 3. njoftimit me anë të postës elektronike, kur mbrojtësi ka vendosur adresë *email*-i në rekurs. Fakti

që personi në gjykim vuan dënimin në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, nuk përbën shkak për shfuqizimin e dispozitës, pasi ajo nuk e cenon procesin e rregullt ligjor, për sa kohë mbrojtësi merr dijeni për procesin gjyqësor përmes mënyrave të njoftimit.

9.3 Pretendimi për shfuqizimin e nenit 437, pika 3, është i pabazuar dhe në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës dhe atë të GJEDNJ-së. Kërkuesi nuk ka arritur të përcaktojë në nivel kushtetues cenimin real dhe të drejtpërdrejtë të të drejtave dhe lirive themelore, si rrjedhim i përmbajtjes së nenit 473, pika 3, të KPP-së. Kjo dispozitë nuk ka ndryshuar asnjëherë që nga momenti i miratimit. Zbatimi i saj nuk sjell ndikim negativ përveçse ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në garantimin e standardeve të procesit të rregullt ligjor. Shfuqizimi i normave të miratuara përpara hyrjes në fuqi të Kushtetutës konstatohet rast pas rasti nga ana e Gjykatës, e cila e ka analizuar këtë dispozitë në kuadër të një tjetër ankimi kushtetues dhe nuk e ka shfuqizuar atë. Përfaqësimi me mbrojtës ligjorë në Gjykatën e Lartë lidhet me njohjen dhe ekspertizën ligjore që duhet të ketë pala në procesin gjyqësor. Në sistemin gjyqësor shqiptar, Gjykata e Lartë është gjykatë ligji dhe nuk kryen analizë dhe vlerësim të fakteve, ndaj prezenca e të pandehurit nuk ndikon në zhvillimin e procesit përpara saj.

10. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme** ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

10.1 Për procesin gjyqësor

10.1.1 Pretendimi për cenimin e *parimit të gjykatës së caktuar me ligj* është i pabazuar, pasi pretendimi i lidhur me moskompetencën nuk është ngritur nga i pandehuri apo mbrojtësi i tij as gjatë seancës paraprake, as përpara shqyrtimit gjyqësor (në asnjë shkallë tjetër gjykimi). Nuk ka asnjë kërkim nga kjo palë lidhur me ripërsëritjen e fazës së seancës paraprake. Po kështu, vlerësimi i moskompetencës territoriale bëhet *ex ante* dhe jo *ex post*. Sipas nenit 86 të KPP-së përjashtohet si shkak për prishje të vendimit nga gjykata e apelit mospasja e kompetencës tokësore.

10.1.2 Pretendimi për cenimin e *së drejtës së aksesit në gjykatë* është i pabazuar, pasi njoftimi për datën, orën dhe trupin gjykues të caktuar për seancën gjyqësore është kryer nëpërmjet njoftimit me shpallje dhe në faqen elektronike zyrtare të Gjykatës



së Lartë. Nga ana tjetër, sipas nenit 436, pika 3, njoftimi elektronik bëhet kur palët kanë adresa elektronike të deklaruar ose të njohura, ndërkohë që nuk rezulton që mbrojtësi t'i ketë deklaruar këto adresa për efekt njoftimi në kuadër të këtij procesi. Po kështu, i pandehuri është rekursuesi, i cili ka caktuar mbrojtës dhe ka kërkuar përshpejtim të procesit. Këto fakte tregojnë se ai ka pasur interesin për të ndjekur ecurinë e çështjes së tij. Pretendimi për zhvillimin e gjykimit në mungesë të të miturit në konflikt me ligjin është gjithashtu i pabazuar, pasi jo vetëm nuk është ngritur si i tillë në rekurs, por rezulton se ai është thirrur nga gjykata në gjykim dhe ka shprehur vullnetin për të mos marrë pjesë në seancë gjyqësore.

10.1.3 Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur është i pabazuar, pasi nuk është ngritur si i tillë në rekurs, si dhe nuk mbështetet në aktet e dosjes dhe dispozitat procedurale. I pandehuri është thirrur në gjykim dhe ka shprehur vullnetin për të mos marrë pjesë në seancë dhe për pasojë prania e psikologes nuk ka qenë detyrim.

10.1.4 Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe të paanshme është i pabazuar, pasi argumentet për parregullsitë dhe për proces të dyshimtë në marrjen e fashikullit nga gjyqtari, pa u caktuar çështja me short apo caktimin e datës së seancës në dhomë këshillimi ngrihen në nivel hipotezash dhe nuk çojnë në përfundime për shkelje të normave kushtetuese në nxjerrjen e vendimit gjyqësor. Procedura e ndjekur, njoftimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë lidhur me çështjen dhe shpallja e datës 2.11.2012, është bërë në përputhje me ligjin dhe praktikën e kësaj gjykate. Shortimi i çështjes provohet qartazi në dokumentin *Regjistri i veprimeve*, fleta nr. 1 e akteve të dosjes.

10.1.5 Pretendimi për cenimin e parimit për gjykim të drejtë është i pabazuar, pasi në kushtet kur një veprim i caktuar procedural ka një rregullim të posaçëm ligjor, referenca në dispozita gjenerike dhe në akte nënligjore është e gabuar. Neni 436/a i KPP-së legjitimon faktin se procesverbali i mbajtur në datën 6.12.2022, përmbush të gjitha kriteret për t'u konsideruar akt i vlefshëm e konform normave procedurale, kur për më tepër neni 122 i KPP-së parashikon shprehimisht rastet e pavlefshmërisë së procesverbalit të seancës.

10.1.6 Pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë përmban të gjitha

elementet formale dhe arsyetuese për çdo pretendim të ngritur në rekurs.

10.2 Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, është i pabazuar, pasi duke u nisur nga arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë, vërehet se ajo nuk e ka cilësuar rrethanë rënduese faktin se i pandehuri vjen nga një familje me formim nën mesatare. Po kështu, gjatë procesit gjyqësor nuk konstatohet të jenë cenuar të drejtat e kërkuarit e aq më tepër kjo të jetë bërë për arsye familjare. Arsyetimi i gjykatës lidhet me faktorë që do të ndihmonin në riintegrimin e tij, në kuadër të interesit më të lartë të të miturit. Pretendimi për shkelje kushtetuese në lidhje me ndalimin e zbatimit të gjykimit të shkurtuar për të miturit që kanë kryer vepra penale, ku parashikohet dënim i përjetshëm, nuk është i bazuar si në dispozitën konkrete, ashtu edhe në lidhje me interpretimin e gjykatave. Po kështu, pretendimi se në vendimin nr. 00-2022-641, datë 12.5.2022, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm lidhur me gjykimin e shkurtuar për të miturin në konflikt me ligjin është i pabazuar.

10.3. Pretendimi për cenimin e së drejtës për të mos u dënuar pa ligj është i pabazuar. Sipas këtij parimi kërkohet ekzistenca e një baze ligjore për të dhënë një dënim. Në kohën e dënimit të kërkuarit ka pasur një parashikim ligjor në nenin 79, shkronja "a", të KP-së, që e bënte të dënueshme vrasjen në rrethana cilësuese, të kryer ndaj të miturit. Po kështu në nenin 50, shkronja "a", të KP-së ishte e parashikuar që kryerja e veprës penale për motive të dobëta rëndonte dënimin. Po kështu, në bazë të nenit 29 të KP-së dhe nenit 97/1 të KDPM-së, burgimi si lloj dënimi i vendosur ndaj kërkuarit përfshihej në llojin e dënimeve të parashikuara nga ligji dhe sipas dispozitave përkatëse dënimin me 12 vjet burgim nuk kalonte kufijtë e KDPM-së. Nga ana tjetër, në dhënien e vendimit, gjykatat janë bazuar në provat e formësuar në respektim të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve. Çdo vlerësim për cilësimin juridik të veprës penale dhe mënyrën e zbatimit të ligjit kur nuk konstatohen shkelje të procesit të rregullt ligjor është jashtë juridiksionit kushtetues.

10.4 Pretendimi për cenimin e parimit të proporcionalitetit është i pabazuar, pasi interpretimi dhe zbatimi i ligjit është detyrë e gjykatave të zakonshme. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë dy shkaqe për mospranimin e kërkesës për gjykim të



shkurtuar, ku i pari lidhet me ushtrimin e diskrecionit të saj bazuar në nenin 405, pika 6, të KPP-së, për shkak se kishte dyshime se cilësimi juridik i veprës penale i përcaktuar nga prokurori ishte i gabuar dhe i dyti me parashikimin ndalues sipas nenit 403, pika 2, të KPP-së. Si dispozita penale, ashtu edhe qëndrimi i gjykatave nuk pasqyrojnë problem kushtetues në lidhje me cenimin e të drejtave themelore. Legjislacioni penal i ka garantuar të miturit në konflikt me ligjin mbrojtje e trajtim të veçantë, që ndryshon ndjeshëm nga sistemi i përgjithshëm i dënimit penal dhe këto garanci respektojnë nenin 54 të Kushtetutës dhe të drejtën ndërkombëtare për fëmijët. Legjislatori ka detyrimin dhe të drejtën të përcaktojë politika të caktuara penale për sa kohë që ato nuk cenojnë thelbin e të drejtave e lirive themelore të njeriut. Ky legjitimitet rrjedh nga zbatimi i drejtpërdrejtë i nenit 17 të Kushtetutës, që nuk përjashton ndonjë të drejtë nga kufizimi. Kur të miturit i është garantuar tashmë me ligj një sistem i diferencuar dënimi, ndalimi i aksesit në një institut të caktuar, siç është ai i gjykimit të shkurtuar, i parashikuar shprehimisht në ligj për shkak të rëndësisë së posaçme të marrëdhënieve juridike që mbrohen, duke përfshirë në këtë ndalim vetëm veprat penale për të cilat parashikohet burgim i përjetshëm, nuk cenon në thelb asnjë të drejtë kushtetuese.

10.5 Për shfuqizimin e dispozitave ligjore

10.5.1 Pretendimi për shfuqizimin e nenit 436, pika 2, të KPP-së është i pabazuar, pasi kërkuesi nuk ka arritur të individualizojë dispozitën kushtetuese të cenuar dhe nuk ka arritur të argumentojë shkaqet e pretenduara të antikushtetutshmërisë, pasi neni 436, pika 2, parashikon të drejtën e gjyqtarit relator për të caktuar datën dhe orën e shqyrtimit të seancës dhe jo njoftimet.

10.5.2 Pretendimi për shfuqizimin e nenit 437 të KPP-së është i pabazuar, pasi në çështjen konkrete nuk provohen pasoja të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuenin. Po kështu, neni 178, pika 1, i Kushtetutës ka përcaktuar të kundërtën e asaj që pretendohet në kërkesë, pasi nga përmbajtja e tij rezulton se nevojitet një ligj që do të mund të shfuqizonte shprehimisht këtë dispozitë dhe jo që ajo të konstatohej apriori. Përmbajtja e dispozitës së kundërshtuar nuk kufizon në thelb të drejtën e mbrojtjes, por synon të garantojë mbrojtje efektive, profesionale e cilësore. Me vendimin nr. 25, datë 30.7.2003, Gjykata është shprehur edhe më parë

lidhur me përmbajtjen e kësaj dispozite dhe ka dalë në përfundimin për pajtueshmërinë e saj me Kushtetutën.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

12. Në çështjen konkrete, referuar objektit të ankimit kushtetues individual, kërkuesi ka kundërshtuar vendimin përfundimtar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në të cilin ai ka qenë palë ndërgjyqëse, ndërkohë që në përmbajtjen e tij ai ka ngritur pretendime edhe ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Po kështu, ai ka kundërshtuar edhe përmbajtjen e neneve 436, pika 2 dhe 437 të KPP-së, për të cilat, bazuar në përmbajtjen e pretendimeve, Gjykata vlerëson se, në thelb, kanë të bëjnë me parashikimet e neneve 436, pika 3 dhe 437, pika 3, të KPP-së.

13. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, për sa i përket vendimit gjyqësor të kundërshtuar, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor për vendimin përfundimtar të të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

14. Për sa i përket legjitimitimit *ratione personae* të kërkuetit në lidhje me kundërshtimin e dispozitave ligjore, Gjykata vëren se kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e neneve 436, pika 3 dhe 437, pika 3, të



KPP-së, duke paraqitur si shkak pretendimin se si rezultat i zbatimit të këtyre dispozitave atij i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në aspekt të së drejtës për akses në gjykatë dhe për t'u mbrojtur personalisht. Gjykata vëren se neni 436, pika 3, i KPP-së rregullon mënyrën e njoftimit të palëve për datën dhe orën e gjykimit në Gjykatën e Lartë, ndërsa neni 437, pika 3, i KPP-së rregullon shqyrtimin gjyqësor të çështjes nga Gjykata e Lartë në prani të palëve.

15. Referuar dispozitave që rregullojnë rekursin në Gjykatën e Lartë, Gjykata vëren se shqyrtimi në këtë gjykatë kalon në një ose në dy faza. Në fazën e parë, që njihet dhe si faza seleksionuese, neni 433 i KPP-së parashikon shqyrtimin e rekursit në lidhje me kushtet e pranueshmërisë, në dhomën e këshillimit, ku në mungesë të ekzistencës të të cilave Gjykata e Lartë disponon për mospranimin e tij, duke i dhënë kështu fund shqyrtimit. Ndërkohë, në rastin kur rekursi plotëson kushtet e pranueshmërisë, në fazën e dytë çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore, si rregull, në dhomën e këshillimit mbi bazë dokumentesh (neni 436/a i KPP-së) ose në prani të palëve në raste përjashtimore (neni 437 i KPP-së), shqyrtim për të cilin neni 436, pika 3, i KPP-së parashikon njoftimin e palëve për ditën dhe orën e gjykimit të paktën 30 ditë përpara, përmes afishimit (shpalljes) në këndin e njoftimeve të Gjykatës së Lartë dhe në faqen elektronike zyrtare të saj, sikundër edhe përmes njoftimit elektronik në rastin kur palët kanë adresë elektronike të deklaruara ose të njohura. Edhe nga pikëpamja strukturore, neni 433 i KPP-së bën pjesë në seksionin e rregullave të përgjithshme që normojnë paraqitjen e rekursit, ndërsa neni 436 i tij është pjesë e seksionit që përmban dispozita që rregullojnë shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë.

16. Duke ardhur në rastin konkret, Gjykata vëren se rekursi i kërkuar i është nënshtruar vetëm shqyrtimit seleksionues nga Gjykata e Lartë, e cila në dhomën e këshillimit ka vendosur mospranimin e tij me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga ligji (neni 432, pika 1, i KPP-së), pra se nuk plotësonte kushtet e pranueshmërisë për shqyrtim në seancë gjyqësore. Nisur nga kjo, Gjykata vlerëson se kërkuar nuk provon që dispozitat e kundërshtuara, nenet 463, pika 3 dhe 437, pika 3, të KPP-së, kanë gjetur zbatim në rastin e tij dhe si rezultat i zbatimit të tyre atij i janë cenuar

në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe reale të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë, çka do të mund të përligjte interesin e tij për të kërkuar shfuqizimin e këtyre dispozitave. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuar nuk legjitimohet *ratione personae* për kërkimin e shfuqizimit të neneve 436, pika 3 dhe 437, pika 3, të KPP-së.

17. Një kriter tjetër paraprak që duhet të përmbushet për të vënë në lëvizje procesin kushtetues është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja "P", i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ i t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.6.2022; nr. 12, datë 9.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive lidhur me procesin gjyqësor*, Gjykata vëren se pretendimet e ngritura për cenimin e: i. *parimit të gjykatës së caktuar me ligj*; ii. *së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi kërkuar nuk ka marrë pjesë në asnjë fazë të gjykimit të çështjes penale në ngarkim të tij; iii. *së drejtës së aksesit në gjykatë*, pasi gjatë shqyrtimit në seancë paraprake dhe gjatë gjykimit në themel psikologu nuk ka qenë i pranishëm; iv. *parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e kanë konsideruar rrethanë rënduese faktin që ai vjen nga një familje me formim nën mesatar, duke e diskriminuar atë, kërkuar nuk i ka ngritur në rekursin e tij drejtuar Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, Gjykata çmon se lidhur me këto pretendime ai nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "P", të Kushtetutës.

19. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000, ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në këtë kuptim, Gjykata konstaton se procesi gjyqësor është përmbyllur me vendimin nr. 00-2022-1595, datë 6.12.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën



30.3.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione temporis* për pretendimet e tij ndaj procesit gjyqësor.

20. Lidhur me legjitimitimin *ratione materiae* për kundërshtimin e vendimit gjyqësor, kërkuesi ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi ai nuk është njoftuar për orën dhe datën e gjykimit të rekursit në dhomën e këshillimit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata vëren se çështja objekt shqyrtimi që është paraqitur për gjykim përpara Gjykatës së Lartë është e regjistruar dy vjetët e fundit, pasi rekursi i ushtruar nga kërkuesi përmes mbrojtësit të tij është regjistruar në datën 17.2.2022. Nisur nga kjo datë e deri në datën 6.12.2022, kur çështja është shqyrtuar në dhomën e këshillimit nga Gjykata e Lartë kanë kaluar më pak se 10 muaj. Kjo e fundit ka marrë në konsideratë kërkesën për përsheptim gjykimi të datës 21.6.2022, të depozituar nga përfaqësuesi ligjor i kërkuesit, duke e shqyrtuar rekursin brenda një periudhe 6 -mujore nga momenti i regjistrimit të saj. Thënë sa më sipër, Gjykata thekson se ka juridiksion për gjykimin e pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë që lidhet me procedurën e njoftimit të datës së gjykimit në dhomën e këshillimit gjatë fazës seleksionuese në Gjykatën e Lartë, vetëm nëse ai lidhet me kërkesën për riformësim të trupit gjykues në drejtim të parimit të gjykatës së paanshme. Ndërsa lidhur me pjesën tjetër të pretendimeve për cenimin e së drejtës për akses në gjykatë, për sa i përket faktit se çështja nuk është shqyrtuar në seancë gjyqësore, por në dhomën e këshillimit, megjithëse kishte kërkesë për njësim të praktikës gjyqësore, duke pamundësuar paraqitjen e ankimeve kundër vendimit për revokimin e seancës sipas neneve 407 dhe 415 të KPP-së, Gjykata vëren se në rastin konkret Gjykata e Lartë ka disponuar me vendim mospranimi, që shqyrtohet gjithmonë në dhomën e këshillimit, për rrjedhim Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruara nga kërkuesi nuk janë ngritur në nivel kushtetues.

21. Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se i është cenuar e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, pasi gjykatat nuk kanë specifikuar se cili ka qenë motivi i dobët në kryerjen e veprës penale dhe as kërkesa e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjykim nuk e

përmban këtë specifikim, fakt që i ka pamundësuar atij të drejtën e mbrojtjes. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se çështjet e interpretimit të ligjit dhe vlerësimit të fakteve dhe provave bëjnë pjesë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, çka nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Lidhur me këtë pretendim, Gjykata çmon se, në thelb, ka të bëjë me vlerësimin e fakteve dhe provave, çka nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues.

22. Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, pasi në fashikullin e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë mungon vendimi për caktimin e datës së gjykimit të çështjes në dhomën e këshillimit dhe akti i caktimit të gjyqtarit përmban edhe datën e zhvillimit të gjykimit në dhomën e këshillimit, që do të thotë se hedhja me short mund të jetë bërë pasi fashikulli i ka kaluar në mënyrë të paligjshme gjyqtarit relator. Po kështu, ai ka pretenduar edhe cenimin e parimit të gjykimit të drejtë, pasi në fashikullin e Gjykatës së Lartë mungon regjistrimi audio i gjykimit në dhomën e këshillimit dhe mungon në tërësi transparenca e procesit, të cilat krijojnë dyshime për paanësinë e gjykatës. Lidhur me këto pretendime, Gjykata çmon se argumentet e parashtruara nga kërkuesi kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit dhe nuk janë ngritur në nivel kushtetues.

23. Po kështu, sipas kërkuesit është cenuar parimi i ligjshmërisë, pasi relatori i çështjes dhe këshilltari ligjor në Gjykatën e Lartë kanë vënë në dyshim zbatimin korrekt të ligjit material me rëndësi për njësimin e praktikës, si dhe standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë nuk jep asnjë përgjigje për konstatimet që parashtrohen nga këshilltari dhe relatori i çështjes në relacionin përkatës dhe ndërmjet këtij dhe vendimit përfundimtar të Gjykatës së Lartë ka dallime në përmbajtje. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se veprimtaria që ushtron këshilltari ligjor ka karakter këshillues dhe ndihmës, në ndryshim nga ajo e gjyqtarit, e cila ka karakter vendimmarrës. Rregullat procedurale që normojnë veprimtarinë e Gjykatës së Lartë kanë përcaktuar në mënyrë të qartë rolin dhe pozicionin, si dhe kompetencat e këshilltarit ligjor gjatë procesit të vendimmarrjes (*shih vendimet nr. 49, datë 5.10.2023; nr. 42, datë 19.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, Gjykata



thekson se kur pretendimet e ngritura kanë të bëjnë me mospërputhje në linjë dhe në arsyetim ndaj akteve të brendshme me natyrë përgatitore dhe ndihmuese dhe vendimeve përfundimtare, kontrolli kushtetues ushtrohet vetëm ndaj këtyre të fundit. Si rrjedhim, Gjykata vlerëson se këto pretendime të kërkuarit janë haptazi të pabazuara.

24. Për pretendimet e tjera të kërkuarit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, parimit për barazi përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës lidhur me mohimin e së drejtës për gjykim të shkurtuar ndaj kërkuarit, ndërkohë që në një rast tjetër të ngjashëm Gjykata e Lartë e ka lejuar atë dhe së drejtës për të mos u dënua pa ligj të lidhur me parimin e proporcionalitetit, të garantuara nga nenet 17 dhe 29, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se ato bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues dhe si rrjedhim do të shqyrtohen në vijim në lidhje me bazueshmërinë e tyre në themel.

25. Mbështetur në thelbin e argumenteve të pretendimit për cenimin e parimit për barazi para ligjit dhe mosdiskriminimit, në lidhje me të drejtën për gjykim të shkurtuar, Gjykata çmon t'i analizojë ato në drejtim të parimit të sigurisë juridike. Po kështu, Gjykata vlerëson që pretendimin për cenimin e së drejtës për të mos u dënua pa ligj të lidhur me parimin e proporcionalitetit, të garantuar nga nenet 17 dhe 29, pika 1, të Kushtetutës, ta analizojë në këndvështrim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike

26. Kërkuari pretendon se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të sigurisë juridike, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i ka mohuar të drejtën e përfitimit nga gjykimi i shkurtuar, bazuar në interpretimin që ky kolegji i ka bërë nenit 403, pika 2, të KPP-së në raport me nenin 79/a të KP-së, ndërkohë që në interpretim të të njëjtave nene i njëjti kolegji, në një çështje tjetër në ngarkim të të miturit A. Xh. në konflikt me ligjin, në të njëjtat rrethana ligjore, e ka vlerësuar të ligjshëm lejimin e gjykimit të shkurtuar për të miturin, mbi të cilin rëndonte akuzë e njëjtë sikurse për kërkuarin. Në këto kushte kërkuari pretendon se i është cenuar siguria juridike, pasi kishte pritshmëri se do të përfitonte nga zbatimi i gjykimit të shkurtuar.

27. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka propësuar se pretendimi për shkelje

kushtetuese në lidhje me ndalimin e zbatimit të gjykimit të shkurtuar për të miturit që kanë kryer vepra penale për të cilat parashikohet dënim i përjetshëm nuk është i bazuar si në dispozitën konkrete dhe në interpretimin e gjykatave. Po kështu, pretendimi se në vendimin nr. 00-2022-641, datë 12.5.2022, për të miturin në konflikt me ligjin A. Xh., Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm lidhur me gjykimin e shkurtuar për të miturin në konflikt me ligjin është i pabazuar.

28. GJEDNJ-ja ka pohuar se parimi i sigurisë juridike prezumon që dispozitat e zbatueshme të ligjit të brendshëm të jenë mjaftueshëm të aksesueshme, të qarta dhe të parashikueshme në zbatimin e tyre (*shih Lekić kundër Sllovenisë [GC], aplikimi nr. 36480/07, datë 11 dhjetor 2018, § 95; Beyeler kundër Italisë [GC], aplikimi nr. 33202/96, datë 5 janar 2000, § 109; Hentrich kundër Francës, aplikimi nr. 13616/88, datë 22 shtator 1994, § 42; Lithgow dhe tjerët kundër Britanisë së Madhe, aplikimi nr. 9405/81, datë 8 korrik 1986, § 110*). Po sipas GJEDNJ-së, parashikueshmëria e ligjit është një element kryesor i parimit të sigurisë juridike, sipas së cilës ligji duhet të formulohet me qartësi të mjaftueshme për të mundësuar që individët të rregullojnë sjelljen e tyre, duke parashikuar në një shkallë të arsyeshme në rrethanat në fjalë, pasojat që mund të sjellë një veprim i caktuar (*shih Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano kundër Italisë [GC], aplikimi nr. 38433/09, datë 7 qershor 2012, § 141*). Një ligj mund të përmbushë kriterin e parashikueshmërisë edhe nëse personi i interesuar duhet të marrë këshilla të përshtatshme ligjore nga një avokat për të vlerësuar pasojat që mund të sjellë një veprim i caktuar. Kriteri i parashikueshmërisë shpesh ndërthuret me kriteret e mungesës së arbitraritetit dhe masave mbrojtëse procedurale (*shih Lekić kundër Sllovenisë [GC], aplikimi nr. 36480/07, datë 11 dhjetor 2018, § 95, 97*). Në vlerësimin e GJEDNJ-së nëse vendimet kontradiktore të gjykatave të larta janë në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ-së, ajo zbaton testin i cili përcakton, së pari, nëse ekzistojnë dallime të qenësishme në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, së dyti, nëse ligji vendas parashikon mjete për tejkalimin e këtyre mospërputhjeve, së treti, nëse mjete të tilla janë zbatuar dhe, së katërti, nëse janë të përshtatshme, cili do të ishte efekti i tyre (*shih Lawrence Borg kundër Malitës, aplikimi nr. 37537/13, datë 12 janar 2016, § 108*).



29. Në këndvështrim të sa më lart, Gjykata çmon ta analizojë pretendimin e kërkuarit për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, me qëllim që t'i japë përgjigje pyetjes, nëse vendime të ndryshme të Gjykatës së Lartë përbëjnë bazë për të krijuar pritshmëri të ligjshme në drejtim të parashikueshmërisë, njëtrajtshmërisë dhe qëndrueshmërisë së ligjit gjatë zbatimit të tij.

30. Gjykata ka pohuar se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme dhe se ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të kryer rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta. Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë e ligjit, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 29, datë 1.11.2022; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se neni 141 i Kushtetutës i ka dhënë Gjykatës së Lartë kompetencën e shqyrtimit të çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit (*shih vendimin nr. 12, datë 15.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në jurisprudencën kushtetuese Gjykata ka theksuar se autonomia e interpretimit të saj nuk është e pakufizuar, por ndalet përpara interpretimit të qëndrueshëm jurisprudencial të gjykatave të zakonshme, pasi edhe në autonominë e saj të plotë të gjykimit Gjykata nuk mund të mos ketë parasysh një interpretim të tillë që i njeh normës legislative vlerën e saj efektive në jetën juridike, duke qenë se normat janë jo ato që propozohen në mënyrë abstrakte, por ato që zbatohen nëpërmjet interpretimit të gjyqtarit, çka i bën ato norma konkrete dhe të prekshme për palët (*shih vendimin nr. 6, datë 17.2.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Gjithashtu, GJEDNJ-ja është shprehur se kur evidentohen zgjidhje të ndryshme të çështjeve gjyqësore të njëjta, në parim, ato duhet të ndiqen nga unifikimi dhe harmonizimi i praktikës, nëpërmjet mekanizmave të ngritura për këtë qëllim, kryesisht nga Gjykata e Lartë (*shih Nejdet Şabin dhe Periban Şabin kundër Turqisë, aplikimi nr. 13279/05, datë 20.10.2011, §§ 61, 80*).

33. Në rastin konkret, Gjykata vëren se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përfshirë këtu edhe

Gjykatën e Lartë, nuk e kanë pranuar kërkesën e kërkuarit për gjykim të shkurtuar, pasi, në interpretimin e tyre, neni 403, pika 2, i KPP-së nuk lejon aplikimin e këtij gjykimi në rastet kur vepra penale parashikon dhënien e dënimit me burgim të përjetshëm. Duke qenë se vepra penale për të cilën është gjykuar dhe dënuar kërkuari parashikohet në nenin 79, shkronja “a”, të KP-së, dhe ky i fundit parashikon mundësinë e dhënies së dënimit me burgim të përjetshëm, kërkuarit i është mohuar kërkesa për zbatimin e gjykimit të shkurtuar. Gjykata konstaton, gjithashtu, se në një vendim tjetër të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në ngarkim të të miturit A. Xh. në konflikt me ligjin, në të njëjtat rrethana ligjore, ky kolegji e ka vlerësuar të ligjshëm lejimin e gjykimit të shkurtuar për të miturin, mbi të cilin rëndonte akuzë e njëjtë sikurse për kërkuarin.

34. Gjykata vëren se në analizë të KDPM-së rezulton se nuk ka asnjë normë të posaçme që të përcaktojë në mënyrë të shprehur zbatimin e gjykimit të shkurtuar për të miturit në konflikt me ligjin, të cilët dënohen për vepra penale, për të cilat parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm. Në drejtim të standardeve të vendosur edhe nga GJEDNJ-ja, sipas së cilave dispozitat e zbatueshme të ligjit të brendshëm duhet të jenë mjaftueshmërisht të aksesueshme, të qarta dhe të parashikueshme në zbatimin e tyre, duket sikur në rastin konkret, për shkak se nuk ka një dispozitë të posaçme në lidhje me gjykimin e shkurtuar për të miturit, janë gjykatat që përmes interpretimit që u bëjnë dispozitave ligjore qartësojnë normat dhe unifikojnë zbatimin e tyre në vendimet gjyqësore, duke i bërë ato të aksesueshme për publikun. Në këtë kontekst, Gjykata vë në dukje se ekzistenca e dy vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë, ku ajo është shprehur në mënyrë të ndryshme për zbatimin e gjykimit të shkurtuar në rastet e të miturve në konflikt me ligjin, nuk mund të passjellë pritshmëri të ligjshme të kërkuarit për zbatimin e tij, në kushtet kur nuk është kryer një interpretim unifikues apo njësuës në lidhje me të.

35. Në çështjen në shqyrtim, në kushtet kur nuk ka një vendim unifikues ose njësuës të Gjykatës së Lartë në drejtim të zbatimit të gjykimit të shkurtuar për të miturit në konflikt me ligjin për veprat penale që parashikojnë dënimin me burgim të përjetshëm, Gjykata çmon se pritshmëritë e kërkuarit për pranimin e kërkesës për zbatimin e gjykimit të shkurtuar nga Gjykata e Lartë janë të pabazuara.



36. Nën dritën e kësaj analize, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* është i pabazuar.

B.2. *Për cenimin e së drejtës për të mos u dënuar pa ligj të lidhur me parimin e proporcionalitetit, në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*

37. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, u janë referuar kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në KPP-së, ndërkohë që duke qenë i mitur në konflikt me ligjin, ligji i posaçëm e orienton organin procedues që në caktimin e llojit dhe masës së dënimit t'i referohet KDPM-së. Në rastin konkret, KPDM-ja duhej të prevalonte ndaj KPP-së. Po kështu, gjykatat e faktit nuk kanë zbatuar drejt ligjin lidhur me rrethanat lehtësuese dhe rënduese ndaj kërkuesit, si dhe arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë është i mangët dhe i pambështetur në prova, në ligj dhe në standardet kushtetuese, si dhe gjuha e përdorur dhe analiza ligjore janë të pakuptueshme.

38. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e së drejtës për të mos u dënuar pa ligj është i pabazuar, pasi sipas tij kërkohet ekzistenca e një baze ligjore për të dhënë një dënim. Sipas subjektit të interesuar, në kohën e dënimit të kërkuesit ka pasur një parashikim ligjor në nenin 79, shkronja “a”, të KP-së, që e bënte të dënueshme vrasjen në rrethana cilësuese të kryer ndaj të miturit. Po kështu në nenin 50, shkronja “a”, të KP-së ishte e parashikuar që kryerja e veprës penale për motive të dobëta rëndonte dënimin. Në bazë të nenit 29 të KP-së dhe nenit 97/1 të KDPM-së, burgimi si lloj dënimi i vendosur ndaj kërkuesit përfshihej në llojin e dënimeve të parashikuara nga ligji dhe sipas dispozitave përkatëse dënimi me 12 vjet burgim nuk kalonte kufijtë e KDPM-së. Nga ana tjetër, në dhënien e vendimit gjykatat janë bazuar në provat e formësuara në respektim të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve. Çdo vlerësim për cilësimin juridik të veprës penale dhe mënyrën e zbatimit të ligjit, kur nuk konstatohen shkelje të procesit të rregullt ligjor, është jashtë juridiksionit kushtetues. Edhe pretendimi për cenimin e parimit të proporcionalitetit është i pabazuar, pasi interpretimi dhe zbatimi i ligjit është detyrë e gjykatave të zakonshme. Legjislacioni penal i ka garantuar të miturit në konflikt me ligjin mbrojtje e trajtim të veçantë, që ndryshon ndjeshëm

nga sistemi i përgjithshëm i dënimit penal dhe këto garanci respektojnë nenin 54 të Kushtetutës dhe të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës. Po sipas subjektit të interesuar, arsyetimi i vendimit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i përmban të gjitha elementet formale dhe arsyetuese për çdo pretendim të ngritur në rekurs.

39. Gjykata është shprehur se e drejta për të mos u dënuar pa ligj (*nullum crimen nulla poena sine lege*) është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Ky parim duhet të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar. Sipas këtij parimi, çdo vepër penale duhet të parashikohet me ligj dhe individit duhet të jetë objektivist në gjendje, nëse është e nevojshme edhe me ndihmën e interpretimeve gjyqësore, të kuptojë përmbajtjen e normës penale, pra se çfarë veprimesh ose mosveprimesh do ta bëjnë atë përgjegjës penalisht (*shih vendimet nr. 31, datë 29.5.2023; nr. 16, datë 15.6.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Për sa i takon standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se ai është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Po kështu, Gjykata, në mënyrë konstante, ka pohuar se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore (*shih vendimet nr. 5, datë 09.2.2023; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 8, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Prandaj Gjykata ka pranuar arsyetimin në mënyrë të kufizuar të vendimeve të mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, pasi, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 21, datë 16.4.2015; nr. 37, datë 19.9.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur



shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventalisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 42, datë 7.7.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuar nga neni 79, shkronja “a”, të KP-së dhe dënimin e tij me 12 vjet burgim, me arsyetimin se në veprimet e të miturit në konflikt me ligjin janë të pranishme të gjitha elementet që kërkon legjislacioni penal për t’i cilësuar si elemente të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 79, shkronja “a”, i KP-së (*shih paragrafin 57, të vendimit nr. 464, datë 29.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier*). Gjykata e Apelit Vlorë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke arsyetuar se nga ana e saj janë analizuar të gjitha veprimet e kryera prej kërkuesit dhe të gjitha rrethanat dhe provat e paraqitura nga organi i akuzës dhe nga mbrojtja. Pas analizës së hollësishme të tyre, me të drejtë është arritur në përfundimin se ai ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 79, shkronja “a”, i KP-së (*shih faqen 8 të vendimit nr. 112, datë 6.5.2021, të Gjykatës së Apelit Vlorë*).

43. Në analizë të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi në rekurs, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij, pasi nuk përmbante ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432/1 të KPP-së, duke arsyetuar në mënyrë të përmbledhur se Gjykata e Apelit Vlorë ka arsyetuar në mënyrë shteruese në lidhje me elementet e veprës penale “Vrasja në rrethana cilësuese”, të kryer ndaj një të mituri, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e kërkuesit, duke u bazuar në provat e marra dhe të shqyrtuara

në gjykim. Po kështu, ai ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë analizuar një nga një këto elemente të veprës penale të parashikuar nga neni 79/a i KP-së, duke çmuar provat në raport me faktin penal dhe akuzën e atribuuar të gjykuarit. Kolegji Penal ka vlerësuar gjithashtu se pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafët 16 dhe 20, të vendimit nr. 00-2022-1595, datë 6.12.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

44. Në drejtim të pretendimit për cenimin e së drejtës për të mos u dënuar pa ligj, në përgjigje të argumentit të kërkuesit se ky cenim ka ardhur si rezultat i mënyrës së interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, Gjykata çmon të analizojë nëse në arsyetimin dhe interpretimin që Gjykata e Lartë i ka bërë ligjit të zbatueshëm në rastin e kërkuesit ka ose jo elemente të arbitraritetit. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se KPDM-ja nuk ka ndonjë dispozitë ku të parashikohet zbatimi i gjykimit të shkurtuar në rastet e drejtësisë për të mitur. Në një interpretim të integruar të dispozitave të KPP-së dhe KPDM-së, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arritur në përfundimin se gjykimi i shkurtuar nuk mund të zbatohet në gjykimin e çështjes së kërkuesit. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se nuk rezulton që interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë të ketë qenë arbitrar në nivelin që të mund të konsiderohet se kërkuesi është dënuar pa ligj ose në mënyrë joproporcionale.

45. Për më tepër, në lidhje me pretendimin e kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, i cili në vlerësimin e Gjykatës nuk rezultoi arbitrar (*shih supra paragrafin 44*), Gjykata çmon gjithashtu se ai nuk rezulton të jetë i pamjaftueshëm, por i qartë, si dhe nuk ka kundërtënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë.

46. Në këndvështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për të mos u dënuar pa ligj të lidhur me parimin e proporcionalitetit në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

47. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa nuk është e bazuar sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj dhe nuk pranohet.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenet 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 31.1.2024.

Shpallur më 12.3.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Elsa Toska

Anëtarë kundër: Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Ilir Toska

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 8 (F) 2023, që i përket kërkesës Florjan Gega, me objekt: *“Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1595, datë 6.12.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtuës me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, me tjetër trup gjyqësor, pasi kthimi përsëri në Gjykatën e Lartë vlerësohet si joefektiv për zgjidhjen e kësaj çështjeje në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”* ne, gjyqtarët në pakicë, ndajmë qëndrim të ndryshëm nga shumica për sa i përket zgjidhjes së kësaj çështjeje, pasi vlerësojmë se duhet të ishte vendosur pranimi i kërkesës.

2. Në mënyrë të përmbledhur, nga rrethanat e kësaj çështjeje rezulton se kërkesi (i mitur në konflikt me ligjin) është akuzuar për kryerjen, në vitin 2018, të veprës penale të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese ndaj një shtetasi të mitur, sipas nenit 79, shkronja “a”, të Kodit Penal (KP). Gjatë shqyrtimit të kërkesës së prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq, gjyqtari i seancës paraprake nuk ka pranuar kërkesën e përfaqësuesit të kërkesës për aplikimin e gjykimin të shkurtuar, me argumentin se, bazuar në nenin 403, pika 2, të Kodit të Procedurës Penale (KPP), gjykimin i shkurtuar nuk mund të

zbatohet për vepra penale për të cilat parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm, kategori në të cilën bën pjesë edhe vepra penale për të cilën akuzohet kërkesi. Në gjykimin e çështjes në themel kërkesi është deklaruar fajtor për veprën penale që akuzohej, duke u caktuar ndaj tij dënimi me 12 vjet burgim, ku për shkak të refuzimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, ndaj tij nuk është zbatuar ulja e këtij dënimi sipas nenit 406 të KPP-së.

3. Kërkesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, duke pretenduar, ndër të tjera, cenimin e parimit të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit për dy shkaqe, së pari, sepse arsyetimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, sipas të cilit konsiderohet rrethanë rënduese fakti se i pandehuri vjen nga një familje me formim nën mesatar, është qartazi një element diskriminues dhe, së dyti, sepse Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm lidhur me pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar për një shtetas të mitur në konflikt me ligjin, i cili ndodhej në rrethana të njëjta ligjore me të (kërkesin). Në këto kushte, ky i fundit ka pasur pritshmëri të ligjshme se do të përfitonte nga zbatimi i gjykimin të shkurtuar. Për sa i përket shkakut të parë, shumica ka vlerësuar se kërkesi nuk e ka ngritur atë në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, ndaj në këto kushte ai nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës (*shih paragrafin 18 të vendimit*).

4. Për sa i përket shkakut të dytë, pretendimin për cenimin e parimit të barazisë para ligjit shumica ka vlerësuar ta analizojë në drejtim të parimit të sigurisë juridike, duke e trajtuar atë në këndvështrim të faktit nëse vendime të ndryshme të Gjykatës së Lartë përbëjnë bazën për të krijuar pritshmëri të ligjshme në drejtim të parashikueshmërisë, njëtrajtshmërisë dhe qëndrueshmërisë së ligjit dhe zbatimit të tij (*shih paragrafin 29 të vendimit*). Ajo ka arritur në përfundimin se ndonëse kërkesi ka sjellë në vëmendje një vendim tjetër në të cilin Gjykata e Lartë ka pranuar gjykimin e shkurtuar, ky fakt nuk mund të konsiderohet i tillë që të krijojë pritshmëri të ligjshme në drejtim të parashikueshmërisë, njëtrajtshmërisë dhe qëndrueshmërisë së ligjit e zbatimit të tij. Shumica ka vënë në dukje se ekzistenca e dy vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë, ku ajo është shprehur në mënyrë të ndryshme për zbatimin e gjykimin të shkurtuar në rastet e të



miturve në konflikt me ligjin, nuk mund të passjellë pritshmëri të ligjshme për kërkuesin në kushtet kur nuk ka një vendim unifikues ose njëses të Gjykatës së Lartë në drejtim të zbatimit të gjykimit të shkurtuar për të miturit në konflikt me ligjin për veprat penale që parashikojnë dënimin me burgim të përjetshëm, ndaj, për rrjedhojë, pritshmëritë e kërkuesit për pranimin nga Gjykata e Lartë të kërkesës së tij për zbatimin e gjykimit të shkurtuar janë të pabazuara (*shih paragrafët 33–35 të vendimit*).

5. Në ndryshim nga shumica çmojmë se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë para ligjit të lidhur me atë të sigurisë juridike, si pjesë e procesit të rregullt ligjor të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, është i bazuar. Gjithashtu, nisur nga fakti se ky pretendim i kërkuesit nuk ka gjetur përgjigje në vendimin e Gjykatës së Lartë, shumica duhet ta trajtonte të lidhur edhe me standardin e arsytimit të vendimit.

6. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se parimi i sigurisë juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimin nr. 11, datë 21.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe GJEDNJ-ja e ka konsideruar parimin e sigurisë juridike si një ndër aspektet thelbësore të shtetit të së drejtës (*shih Nejdett Şahin and Perihan Şahin kundër Turqisë, datë 20.10.2011, § 56*). Për sa u përket vendimeve gjyqësore kontradiktore, GJEDNJ-ja është shprehur se ato mund të zvogëlojnë besimin e publikun në sistemin gjyqësor (*shih Ferreira Santos Pardal kundër Portugalisë, datë 30.7.2015, § 42*). Në parim, GJEDNJ-ja nuk ka kompetencë të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave kombëtare, të dhëna në procese në dukje të ngjashme, pasi ajo respekton parimin e pavarësisë së gjykatave. Dhënia e dy vendimeve të ndryshme nuk mund të konsiderohet jurisprudencë kontradiktore kur ajo justifikohet me ndryshime në situatën faktike (*shih Hayati Çelebi dhe të tjerë kundër Turqisë, datë 9.2.2016, § 52*). Gjithsesi, në rastin kur kontradiktat zhvillohen në organin më të lartë gjyqësor, ajo gjykatë bëhet vetë burim i pasigurisë juridike, duke minuar kështu parimin e sigurisë juridike dhe ulur besimin e publikut në sistemin gjyqësor (*shih Beian kundër Rumanisë (nr.1), 6.12.2007, § 38*). Një nga kriteret që GJEDNJ-ja përdor për të vlerësuar nëse jurisprudenca është kontradiktore është edhe fakti i ekzistencës së një mekanizmi për të shmangur kontradiktat dhe nëse ky mekanizëm

është zbatuar (*shih Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë, datë 29.11.2026, § 118*).

7. Gjithashtu në kuadër të parimit të subsidiaritetit, Gjykata e Lartë ka detyrimin t'u përgjigjet të gjitha pretendimeve me natyrë kushtetuese edhe në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit dhe kontrolluese e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta. Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të vihet në lëvizje për ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 29, datë 1.11.2022; nr. 19, datë 7.7.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Gjithashtu, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në rastin në shqyrtim vërejmë se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 06.12.2022, ka arsyetuar se neni 403, paragrafi i dytë, i KPP-së ndalon aplikimin e ritit procedural të gjykimit të shkurtuar dhe rrjedhimisht uljen e dënimit në masën e një të tretës kur gjykohen vepra penale të cilat parashikojnë dënimin me burgim të përjetshëm, duke mos e lidhur këtë ndalim me moshën e të pandehurit, por vetëm me veprën penale të kryer. Në këtë kuptim, Gjykata e Lartë e ka gjetur të bazuar arsyetimin e dy gjykatave më të ulëta për mospranimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar nga kërkuesi.

10. Ndërsa në një vendim tjetër të mëparshëm të saj të datës 12.5.2022, duke mos e vënë në diskutim



zbatimin e rritit të gjykimit të shkurtuar për të miturin në konflikt me ligjin, i cili kishte kryer vepër penale të dënueshme me burgim të përjetshëm, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin e çështjes në atë gjykatë për rishqyrtim, në një kohë kur gjykata e apelit kishte prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë pikërisht sepse kjo e fundit kishte proceduar me ritin e gjykimit të shkurtuar dhe jo me procedurë të zakonshme gjykimi. Këtë vendimarrje Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka konsideruar rrjedhojë të zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal dhe ka vlerësuar se gjykata e apelit nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore që në zbatim të nenit 427, pika 3, të KPP-së të vendoste përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, si dhe në zbatim të nenit 428 të KPP-së i cili ka ndalim për gjykatën e apelit për të vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve gjykatës së shkallës së parë në rastet që nuk parashikohen nga kjo dispozitë. Ndërkohë, në rigjykimin e çështjes, gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin e datës 1.6.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të prokurorit, duke arsyetuar se për shkak të mbrojtjes ligjore të posaçme që i është dhënë të miturit në konflikt me ligjin, ndalesa e parashikuar në nenin 403, pika 2 të KPP-së nuk gjen zbatim, përderisa dënueshmëria maksimale (burgimi i përjetshëm) për të miturin ndalohet nga vetë ligji. Po kështu, ky kolegji ka vlerësuar se kjo dispozitë, në rastin kur të miturit janë autorë të veprës penale, nuk mund të interpretohet si dispozitë e izoluar në legjislacionin penal, por në bazë të interpretimit sistematik, duhet të analizohet dhe interpretohet në raport harmonik me parashikimet e dispozitave materiale të KP-së dhe Kodit Penal për të Mitur.

11. Nisur nga sa më lart konstatojmë se ndonëse detyra kryesore e Gjykatës së Lartë është zgjidhja e konflikteve të interpretimit të ligjit të zakonshëm, në një hark të shkurtër kohor në jurisprudencën e saj janë të pranishme kontradikta të dukshme në lidhje me mënyrën e zbatimit të gjykimit të shkurtuar për të miturit që kanë kryer një vepër penale të dënueshme me burgim të përjetshëm. Në parim jemi të mendimit se zhvillimi i jurisprudencës është i pashmangshëm në një sistem gjyqësor dhe nuk është në kundërshtim me administrimin e duhur të drejtësisë. Përkundrazi, ai është më se i pranueshëm në një shtet të së drejtës, pasi në të kundërt një

jurisprudencë e ngurtë do të pengonte reformat dhe përmirësimin e sistemit të drejtësisë. Megjithatë, në rastin konkret nuk ndodhemi përpara një situatë të tillë, pasi kontradiktat në vendimarrje nuk janë shfaqur si pasojë e ndryshimit të jurisprudencës.

12. Në këtë kuptim, diferencat e evidentuara në çështjet e ngjashme të lartpërmendura të Gjykatës së Lartë nuk mund të konsiderohen si evoluim dinamik i jurisprudencës dhe as mund të thuhet se kjo gjykatë ka aplikuar mekanizmin e njësimiit të praktikës së saj për sa i përket kërkesës për gjykim të shkurtuar nga të miturit. Ky fakt merr akoma më shumë rëndësi për sa kohë kontradiktat në jurisprudencën e kësaj gjykate në këtë aspekt, janë të tilla që reflektohen edhe në jurisprudencën e gjykatave më të ulëta, të cilat, rrjedhimisht, do të japin vendime kontradiktore në drejtim të interpretimit të ligjit të zbatueshëm. Për më tepër, kjo vendimarrje është e tillë që prek një kategori të gjerë individësh, që janë të miturit që kryejnë vepra penale të rënda për të cilat parashikohet burgimi i përjetshëm.

13. Nisur nga analiza e mësipërme, vlerësojmë se Gjykata e Lartë, pavarësisht qenies në kushtet e një jurisprudencë të pakonsoliduar për sa i përket aplikimit të gjykimit të shkurtuar për të miturit në konflikt me ligjin që akuzohen për vepra penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm, duhet t'i kishte kthyer përgjigje pretendimit të kërkuarit për shkak të natyrës kushtetuese dhe për të qartësuar qëndrimin e saj në lidhje me interpretimin përfundimtar të ligjit procedural penal për këtë aspekt të institutit të gjykimit të shkurtuar. Në këtë drejtim, vëmë në dukje se Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, duhet të ndalej në analizën pse në rastin konkret ajo ka vendosur në mënyrë të ndryshme nga raste të ngjashme për të miturit në konflikt me ligjin të akuzuar për vepra penale për të cilat parashikohej dënimi me burgim të përjetshëm.

14. Për të gjitha arsyet e mësipërme, ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të barazisë para ligjit të lidhur me atë të sigurisë juridike dhe standardin e arsyetimit të vendimit ishte i bazuar, prandaj Gjykata duhej të vendoste pranimin e kërkesës.

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Ilir Toska



VENDIM

Nr. 6, datë 15.2.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Illir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 15.2.2024
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të
dokumenteve çështjen nr. 8 (E) 2023 të Regjistrit
Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Erdi Prifti

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria pranë
Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të
Përgjithshëm Korçë

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 41-2022-
3777 (53 prot.), datë 14.12.2022, të Gjykatës së
Rrethit Gjyqësor Korçë, si i papajtueshëm me
Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 43, 124, 131,
pika 1, shkronja “P” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës
së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika
1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e
Njeriut (*KEDN*); nenet 49, 71 dhe 71/a të ligjit nr.
8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe
funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës
së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Holta Zaçaj, mori
në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, i cili ka kërkuar
pranimin e saj, konstatoi mungesën e prapësimeve
me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë
pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të
Përgjithshëm Korçë (*Prokuroria e Korçës*), si dhe
diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari Erdi Prifti është një prej palëve
ndërgjyqëse (*pala paditëse*) në procesin gjyqësor që
është në shqyrtim përpara Gjykatës së Shkallës së
Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë prej
datës 4.6.2020, me objekt kthimin tërësisht të
pasurisë trashëgimore dhe lirimin e dorëzimit të saj
trashëgimtarëve ligjorë; konstatimin e
pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike
kontrata shitblerjeje dhe goditjen e tyre për falsitet;
njohjen e paditësve si trashëgimtarë ligjorë të
trashëgimlënësit dhe regjistrimin e pasurisë në emër
të tyre. Në gjykimin e paditësit, të përfaqësuar nga
kërkuari Erdi Prifti, që gjithashtu ka të njëjtën cilësi
procedurale, kanë pretenduar se janë trashëgimtarë
ligjorë të të ndjerëve P.K.P., L.K.P. dhe K.P.P., sipas
dëshmimeve përkatëse të trashëgimisë. Ata kanë
pretenduar para gjykatës se pasuritë që duhet të
përfitonin në këtë cilësi janë tjetërsuar në persona të
tretë, sipas kontratës së datës 14.12.1999 të lidhur
para noterit nga shtetasi P.P. (*trashëgimlënësi i palës së
paditur*), ndërkohë që ky i fundit ka ndërruar jetë më
11.11.1997 dhe nuk ka banuar asnjëherë në qytetin e
Tiranës, sikurse rezulton në aktin e kundërshtuar.
Duke qenë se edhe noteri ka ndërruar jetë, nuk
mund të bëhet akt ekspertimi grafik i shkrimeve dhe
nënshkrimeve, por është lehtësisht e provueshme se
shitësi nuk ka pasur zotësi juridike në kohën e
nënshkrimit të kontratës. Duke pretenduar se noteri
ka shkelur ligjin për noterin dhe zyra e regjistrimit
të pasurive të paluajtshme ka regjistruar pasurinë
mbi akte të kundërligjshme, duke u mohuar
paditësve të drejtën e trashëgimisë mbi pasurinë e
paluajtshme, ata i janë drejtuar gjykatës me
kërkesëpadi.

2. Pas paraqitjes në seancë gjyqësore, nga pala e
paditur, të akteve “testament, datë 12.8.1997” dhe
“vërtetim, datë 7.5.1997”, pala paditëse ka paraqitur
kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së
Rrethit Gjyqësor Elbasan ndaj së paditurës V.P. dhe
shtetasit Rr.Ç., kryetar i qendrës administrative nr. 2,
Bashkia Elbasan, i cili ka vërtetuar firmën e shtetasit
P.P. në këto akte, për veprat penale “Falsifikimi i
dokumenteve” dhe “Falsifikimi i vulave”, të
parashikuara nga nenet 186 dhe 190 të Kodit Penal
(*KP*).



3. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, mbi bazën e materialit kallëzues të paraqitur, ka regjistruar procedimin penal nr. 34, datë 08.01.2021 për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, pika 1, i KP-së. Me vendimin e prokurorit të datës 08.02.2021, aktet e këtij procedimi i kanë kaluar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për kompetencë tokësore, e cila ka regjistruar procedimin penal nr. 102 të vitit 2021.

4. Me pretendimin se çështja civile në shqyrtim ka lidhje me çështjen penale dhe se pa përfunduar kjo e fundit nuk mund të vijohet me gjykimin, për sa kohë që pretendohet falsiteti i akteve që kanë shërbyer për disponimin e pronës, bazuar në nenin 297, shkronja “a”, të Kodit të Procedurës Civile (KPC), pala e paditur ka kërkuar pezullimin e gjyimit të çështjes civile deri në përfundimin e çështjes penale. Pala paditëse është shprehur në gjykim se nuk ka interes për pezullimin e çështjes, por e ka lënë në çmim të gjykatës.

5. Me vendimin e datës 14.4.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, bazuar në nenin 297 të KPC-së, që përcakton rastet e pezullimit të gjyimit, mes të cilave “*kur çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative*” (shkronja “a”), ka vendosur pezullimin e gjyimit të çështjes civile deri në përfundimin e çështjes penale që i përket procedimit penal nr. 102 të vitit 2021. Sipas gjykatës, referuar akteve të paraqitura nga pala e paditur, ato kanë lidhje të drejtpërdrejtë me pasurinë trashëgimore që kërkon pala paditëse, pasi në to shprehet vullneti për disponimin e saj të trashëgimlënësi i të paditurave dhe se pjesë e kërtimeve të padisë është edhe goditja e tyre për falsitet. Ajo ka vlerësuar se nëpërmjet çështjes penale pala paditëse kërkon të vërtetojë se pasurinë objekt gjykimi pala e paditur e ka përfutur dhe më pas disponuar në mënyrë të kundërligjshme, duke goditur titullin e saj dhe kontratat e kalimit tek të tretët. Ky vendim i gjykatës së shkallës së parë është lënë në fuqi me vendimin nr. 48, datë 23.6.2021 të Gjykatës së Apelit Korçë.

6. Rezulton, gjithashtu, se me kërkesën e datës 8.6.2021 paditësit kanë kërkuar në gjykatën e apelit marrjen e masës së sigurimit të padisë me pretendimin se pasuria mund të tjetërsohej, për të cilën, me vendimin nr. 4, datë 10.6.2021, Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore. Mbi bazën e ankimit të

tyre të veçantë, çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë dhe me vendimin nr. 00-2021-2165, datë 6.12.2021 të Kolegjit Civil është vendosur mospranimi i tij. Me kërkesën e datës 14.2.2022, paditësit në procesin gjyqësor kanë paraqitur ankim kushtetues për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe konstatimin e cenimit të së drejtës për t’u gjykuar brenda afatit të arsyeshëm. Me vendimin nr. 35, datë 29.3.2022 të Kolegjit të Gjykatës është vendosur moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se vendimet e kundërshtuara janë vendime të ndërmjetme, me karakter procedural, dhe se për sa kohë gjykimi i çështjes është ende në proces në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, kërkesit i kanë të gjitha mundësitë që pretendimet e tyre t’i paraqesin para Gjykatës, pas përfundimit të çështjes në ato gjykata, bashkë me vendimin përfundimtar që përmbyll çështjen e tyre. Në lidhje me kërkesën për konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, Kolegji ka vlerësuar se për sa kohë ankimi i veçantë është gjykuar nga Gjykata e Lartë, nuk arrihet të provohet më interesi i drejtpërdrejtë i kërkesve.

7. Më datë 14.3.2022 kërkuesi Erdi Prifti i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë me kërkesë për informacion në lidhje me ecurinë e hetimeve të procedimit penal nr. 102 të vitit 2021, e cila nuk rezulton të ketë marrë përgjigje.

8. Me kërkesën e datës 20.4.2022, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në mbështetje të neneve 399/1, 399/2, pika 1, shkronja “ç” dhe pika 2, 399/5, 399/6 e vijues KPC-së, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të hetimit të çështjes penale që i përket procedimit penal nr. 102 të vitit 2021 dhe përshejtimin e procedurave për hetimin sa më të shpejtë të kësaj çështjeje. Në kërkesë është pretenduar se çështja penale është bërë pengesë për ushtrimin e të drejtave të tij dhe të paditësve të tjerë në procesin civil të pezulluar deri në përfundimin e shqyrtimit të saj. Ai ka pretenduar se edhe pse ka kaluar më shumë se 1 vit e 3 muaj, prokurori nuk ka mbyllur ende hetimet, duke cenuar të drejtën për proces të rregullt në drejtim të kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve.

9. Me e-mail-in e datës 10.5.2022 të sekretarisë së gjykatës së shkallës së parë, kërkuesi është njoftuar se kjo çështje është regjistruar dhe shortuar e se



ndodhet për shqyrtim të gjyqtari. Për rrjedhojë, me kërkesën e datës 27.7.2022, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Apelit Korçë, në mbështetje të neneve 399/1 e vijues të KPC-së, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të kërkesës së regjistruar në gjykatën e shkallës së parë, si edhe përshpejtimin e procedurave, duke pretenduar se ajo gjykatë ka shkelur afatin 45-ditor të përcaktuar në nenin 399/7, pika 2, të KPC-së.

10. Në vijim, më datë 12.12.2022, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj, të së drejtës për shqyrtimin brenda afatit të arsyeshëm të kërkesave të paraqitura në gjykatën e shkallës së parë dhe atë të apelit, si dhe përshpejtimin e këtyre procedurave. Me vendimin nr. 11, datë 20.1.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, duke vlerësuar se kërkuesi nuk provonte më interesin për vënien në lëvizje të këtij gjykimi. Sipas Kolegjit, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt për shkak të mosgjykimit brenda afatit ligjor të kërkesës së paraqitur në kuptim të neneve 399/1 e vijues të KPC-së, për konstatimin dhe përshpejtimin e procedurave të hetimit të çështjes penale, ndërkohë që ka rezultuar se ajo kërkesë ishte marrë në shqyrtim nga gjykata e shkallës së parë dhe kishte një vendimmarrje në lidhje me të.

11. Me vendimin nr. 41-2022-3777 (53 prot.), datë 14.12.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të hetimit të çështjes penale që i përket procedimit penal nr. 102 të vitit 2021. Sipas gjykatës, kërkuesi nuk rezulton të jetë palë në një proces civil ose të ketë paraqitur padi civile në proces penal, si dhe të jetë person ndaj të cilit zhvillohet hetim penal ose gjykohet akuzë. Kërkuesi ndodhet në cilësinë e kallëzuesit/viktimës së veprës penale në një çështje që ndodhet në fazën e hetimit, për rrjedhojë ai nuk përfshihet në parashikimet e nenit 6 të KEDNJ-së, për të cilin duhet të garantohet e drejta për proces të rregullt, në elementin e përfundimit të hetimeve apo gjykimit brenda një afati të arsyeshëm (*shih fagen 6 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë*).

12. Për rrjedhojë, në datën 13.4.2023 kërkuesi, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas

objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar më datë 2.5.2023. Me vendimin e datës 21.6.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

13. Në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 98/2018 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, emërtimi i gjykatave të shkallës së parë ka ndryshuar në “gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”. Për këtë shkak, në tekstin e këtij vendimi, emërtimet e gjykatës dhe të prokurorisë kompetente janë përdorur në përkëmbim respektiv të njëri-tjetrit, duke iu referuar kohës që janë kryer veprimet dhe janë marrë vendimet përkatëse prej tyre.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

14. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, në drejtëm të:

14.1 *Standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm*, pasi çështja penale e regjistruar mbi kallëzimin e kërkuetit ndodhet ende në hetim dhe ajo pengon palën paditëse në procesin gjyqësor për të ushtruar të drejtat juridike civile. Çështja penale është regjistruar më 08.01.2021 dhe me vendimin e datës 08.02.2021 i ka kaluar për kompetencë tokësore Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila ka regjistruar procedimin penal nr. 102/2021, por ende nuk janë mbyllur hetimet. Kërkuesi si palë në procedim nuk ka bërë ndonjë kërkesë për zgjatjen e hetimeve. Me kërkesën e datës 14.03.2022 ai i është drejtuar prokurorisë për informacion në lidhje me ecurinë e hetimeve dhe nuk ka marrë përgjigje prej saj. Ky standard është cenuar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, që ka vendosur rrëzimin e kërkesës për cenimin e së drejtës për proces të rregullt, pasi e ka mbajtur fashikullin e gjykimit për më shumë se 7 muaj pa dhënë një vendim, duke shkelur afatin procedural 45-ditor të përcaktuar nga neni 399/7, pika 2, i KPC-së.

14.2 *Së drejtës së aksesit*, pasi gjykata nuk ka marrë për bazë faktin që kërkuesi është palë në procesin gjyqësor penal e civil, për rrjedhojë ai ka legjitimitet aktiv, pasi i cenohet e drejta e pronësisë si palë



paditëse dhe kallëzues, në kuptim të nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së dhe neneve 399/1 e vijues të KPC-së. Kërkesa ka natyrë civile dhe ligji procedural nuk përcakton se cilat janë subjektet që i drejtohen gjykatës, pra organi i akuzës apo i pandehuri. Për rrjedhojë, ajo gjykatë ka disponuar jo në bazë të ligjit, në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike.

14.3 *Parimit të barazisë para ligjit*, pasi kërkuesi është palë në procesin gjyqësor/hetimor të iniciuar nga pala paditëse në procesin gjyqësor civil, ndaj ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

14.4 *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi gjykata nuk ka dhënë një vendim që shprehet për objektin e kërkesës së paraqitur nga kërkuesi për konstatimin e cenimit të afatit të përfundimit të hetimeve penale.

1. **15. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Korçës**, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

16. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shkrimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

17. Në kuptim të dispozitave të mësipërme, individ, si subjekt i kushtëzuar, mund të paraqesë ankimi kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të. Gjykata ka pohuar se,

në parim, statusi i “viktimës” përjashtohet vetëm nëse organet publike kanë njohur shkeljen, në mënyrë të shprehur ose në substancë, dhe më pas e kanë riparuar atë (*shih vendimet nr. 64, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Kërkuesi, në objektin e kërkesës në shqyrtim, ka kërkuar si shfuqizimin e vendimit nr. 41-2022-3777 (53 prot.), datë 14.12.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me të cilin është vendosur rrëzimi i kërkesës për konstatimin e afatit të arsyeshëm gjatë hetimit penal, ashtu edhe konstatimin e cenimit të kësaj të drejte në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të hetimeve që janë duke u kryer nga Prokuroria e Korçës. Për sa kohë që, për shkak të mos përfundimit të hetimeve për kallëzimin e paraqitur nga kërkuesi, vijon të jetë ende i pezulluar, sipas informacionit të ardhur në Gjykatë, procesi civil i vënë në lëvizje edhe nga kërkuesi si palë paditëse, përmes të cilit kërkohet të mbrohet e drejta e pronësisë e pretenduar e cenuar, ai, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, pasi ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

19. Një kriter tjetër paraprak është edhe ai për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Gjykata ka theksuar se ky lloj ankimi kushtetues është mjeti juridik në dispozicion të individit për të garantuar të drejtën për proces të rregullt dhe në këto raste, bazuar në nenin 42 të Kushtetutës, ajo shqyrton pretendimin kryesor që lidhet me kohëzgjatjen e procesit të kundërshtuar, ndërsa procedurat dhe vendimet gjyqësore të zakonshme që kanë shqyrtuar këto kërkesa, në kuptim të neneve 399/1 e vijues të KPC-së, janë në funksion pikërisht të kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimet nr. 64, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në këtë drejtim rezulton se kërkuesi, pasi i është drejtuar Prokurorisë së Korçës me kërkesë për informacion në lidhje me fazën në të cilën ndodhet hetimi penal, i është drejtuar gjykatës me kërkesën e datës 20.4.2022, në mbështetje të neneve 399/1 e vijues të KPC-së, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të hetimit të çështjes penale që i përket



procedimit penal nr. 102 të vitit 2021 dhe përsheptimin e procedurave për hetimin sa më të shpejtë të kësaj çështjeje. Në lidhje me këtë kërkesë, me vendimin nr. 41-2022-3777 (53 prot.), datë 14.12.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur rrëzimin e saj, vendim, i cili, në kuptim të nenit 399/8 të KPC-së, është përfundimtar dhe i formës së prerë. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuarit për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual.

21. Kërkuar legjitimohet edhe *ratione temporis* në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe vendimi i kundërshtuar i gjykatës së shkallës së parë që ka shqyrtuar kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm mban datën 14.12.2022, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 13.4.2023 (nëpërmjet shërbimit postar), pra brenda afatit 4-mujor.

22. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuar ka ngritur pretendime për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e së drejtës së aksesit, barazisë para ligjit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të cilat, si pretendime me natyrë kushtetuese, bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Duke qenë se këto pretendime janë në funksion të pretendimit kryesor për tejzgjatjen tërësore të procedimit penal, i cili ka shkaktuar pezullimin e procesit civil dhe, në këtë mënyrë, është i lidhur drejtpërdrejt me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor civil të vënë në lëvizje gjithashtu prej kërkuarit, Gjykata do t'i shqyrtojë ato në këndvështrim të së drejtës për kohëzgjatje të arsyeshme të procedurave.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës për kohëzgjatje të arsyeshme të procedurave

23. Kërkuar ka pretenduar se çështja penale e regjistruar mbi kallëzimin e tij është ende në hetim dhe nuk ka një vendim nga Prokuroria e Korçës, çka përbën pengesë për të, si palë paditëse në procesin gjyqësor, për të ushtruar të drejtat juridike civile. Çështja penale është regjistruar më 8.1.2021 dhe me vendimin e datës 8.2.2021 i ka kaluar për kompetencë tokësore Prokurorisë së Korçës, e cila ka regjistruar procedimin penal nr. 102/2021, por ende nuk ka mbyllur hetimet. Kërkuar, si palë në

procedim, nuk ka bërë ndonjë kërkesë për zgjatjen e hetimeve por i është drejtuar prokurorisë për informacion në lidhje me ecurinë e tyre dhe nuk ka pasur përgjigje prej saj. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, që ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt, nuk ka marrë për bazë faktin që kërkuar është palë në procesin gjyqësor penal e civil ndaj ka legjitimitet aktiv, duke disponuar në kundërshtim me ligjin dhe me parimin e sigurisë juridike. Në këtë mënyrë ajo gjykatë nuk ka dhënë vendim për objektin e kërkesës së paraqitur nga kërkuar, që është konstatimi i cenimit të afatit të arsyeshëm për përfundimin e hetimeve penale.

24. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushtdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave kushtetues e ligjorë ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në momentin kur jepet vendimi (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata vëren se kërkuar Erdi Prifti është një prej palëve paditëse në procesin gjyqësor me objekt kthimin e pasurisë trashëgimore dhe lirimin e dorëzimit të saj; konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike, kontrata shitblerjeje dhe goditjen e tyre për falsitet; njohjen e paditësve trashëgimtarë ligjorë të trashëgimlënësit, si dhe regjistrimin e pasurisë në emër të tyre. Gjatë procesit gjyqësor janë paraqitur nga pala e paditur disa akte provuese, konkretisht “testament, datë 12.8.1997” dhe “vërtetim, datë 7.5.1997”, për të cilat pala paditëse ka paraqitur kallëzim penal, mbi bazën e të cilit është regjistruar procedimi penal nr. 102 i vitit 2021 për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, pika 1, i KP-së.

26. Procedimi penal është regjistruar fillimisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe me vendim të prokurorit të datës 8.2.2021, aktet i kanë kaluar Prokurorisë së Korçës, e cila ka regjistruar procedimin penal nr. 102 të vitit 2021. Për rrjedhojë, që prej regjistrimit të tij kanë kaluar 3 vjet dhe sipas shkresës nr. 626 prot., datë 26.1.2024 të Prokurorisë së Korçës, në përgjigje të informacionit të kërkuar nga Gjykata, konfirmohet se çështja është ende në hetim pa ndonjë sqarim të



mëtejshëm. Për shkak të këtij procedimi penal çështja civile ku kërkuesi është palë është pezulluar me vendimin e datës 14.4.2021 dhe sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me shkresën nr. 65 prot., datë 30.1.2024, çështja vazhdon të jetë e pezulluar në pritje të rënies së shkakut të pezullimit, pra përfundimit të çështjes penale që i përket procedimit penal nr. 102 të vitit 2021.

27. Gjykata vëren se me ndryshimet e KPC-së të vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykitimit brenda afatit të arsyeshëm, ligjvënësi ka përcaktuar, mes të tjerash, se afat i arsyeshëm në hetimin e veprave penale do të konsiderohet afati maksimal i kohëzgjatjes së hetimeve, sipas Kodit të Procedurës Penale (KPP) (neni 399/2, pika 1, shkrinja “ç”).

28. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se sipas nenit 323 të KPP-së, afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, dhe gjashtë muaj për veprat penale të parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b” të nenit 75/a të këtij Kodi. Ky afat mund të zgjatet, sipas nenit 324 të KPP-së, për një kohë deri në tre muaj. Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t’i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur, ndërkohë që tej afatit 2-vjeçar, në raste të jashtëzakonshme, afati i hetimit mund të zgjatet vetëm me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm deri në 1 vit, për çdo zgjatje jo më shumë se tre muaj. Sipas pikës 3 të këtij neni, vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve jepet i arsyetuar dhe u njoftohet të pandehurit dhe viktimës, që, sipas nenit 325 të KPP-së, kanë të drejtën e ankimit në gjykatë, e cila kur vlerëson se ankimi duhet të pranohet dhe hetimet nuk duhet të vazhdojnë, urdhëron prokurorin që t’i përfundojë ato brenda një afati jo më të gjatë se 15 ditë ose kur hetimet duhet të vazhdojnë, urdhëron prokurorin t’i përfundojë ato brenda një afati të caktuar prej saj.

29. Po ashtu, Gjykata vëren se afatin e përfundimit të hetimeve paraprahe ligji procedural penal e lidh me regjistrimin në regjistrin e njoftimit të veprave penale të emrit të personit që i atribuohet vepra penale, regjistrim i cili përcaktohet si përgjegjësi dhe jo e drejtë e prokurorit, referuar nenit

287, pika 1, të KPP-së, sipas të cilit prokurori shënon në regjister çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale. Ndërkohë, identifikimi i personit për të cilin zhvillohen hetime është përgjegjësi e policisë gjyqësore sipas nenit 295 të KPP-së, por se është prokurori ai që, sipas neneve 24, 277 dhe 304 të këtij kodi, drejton dhe kontrollon hetimet paraprahe dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, të cilën e ka në dispozicion, ndërsa mund të kryejë edhe vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm. Është e qartë se një përcaktim i ndryshëm i afatit të përfundimit të hetimeve paraprahe, duke e lidhur atë me momentin e njoftimit të veprës penale, do të kufizonte mundësinë e organit për ushtrimin e ndjekjes penale në rastet e mungesës së të dhënave për personin të cilit i atribuohet vepra penale. Ndaj nisur nga kjo, në funksion të afatit të përfundimit të hetimeve paraprahe, mbetet e rëndësishme ushtrimi nga prokurori i përgjegjësisë për regjistrimin në regjistrin e njoftimit të veprave penale të emrit të personit që i atribuohet vepra penale, çka nuk nënkupton mundësinë e shmangies ose të neglizhencës së prokurorit në këtë drejtim, por, përkundrazi, një përgjegjësi të shtuar për të në funksion të një hetimi objektiv, të drejtë, efektiv dhe efikas.

30. Gjykata vëren se asaj nuk i është dhënë asnjë informacion nga ana e prokurorisë për gjendjen e procedimit penal, për sa i përket ecurisë dhe stadit të tij, përfshirë edhe për sa i përket kompleksitetit apo pamundësisë objektive për përfundimin e tij, në një kohë kur tashmë kanë kaluar më shumë se 3 vjet nga regjistrimi i këtij procedimi. Në të njëjtën mënyrë ka vepruar prokuroria, qoftë kur kërkuesi, në cilësinë e viktimës nga vepra penale, ka kërkuar një informacion të tillë sipas së drejtës që i japin nenet 58 dhe 279/a të KPP-së, ashtu edhe në rastin e shqyrtimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë të kërkesës së kërkuesit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të hetimit të çështjes penale sipas detyrës së ngarkuar nga neni 399/7, pika 2, i KPC-së, duke mos u gjendur në vendimin e gjykatës ndonjë e dhënë ose element që mund të shërbejë në këtë drejtim. Në këto kushte, duke pasur parasysh se në kallëzimin e tij penal kërkuesi ka identifikuar personat që, sipas tij, kanë kryer veprën penale, si dhe në mungesë të të dhënave të vlefshme në



drejtim të hetimit paraprak të zhvilluar dhe veprimeve të kryera nga prokurori në pikëpamje të kujdesit të treguar për realizimin në kohë të hetimit, nisur nga fakti i pakontestueshëm se hetimi paraprak në rastin konkret vijon tashmë prej më shumë se 3 vjetësh dhe nuk ka asnjë informacion se kur pritet që ai të përfundojë, Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e hetimit paraprak në këtë rast nuk mund të klasifikohet si normale në kontekst të rrethanave të këtij procedimi penal.

31. Për sa më sipër, duke konsideruar se procedimi penal i vënë në lëvizje nga kërkuesi, që është ende në fazën e hetimeve paraprake, kapërcen tejzgjatjen normale të hetimit në kuptim të KPC-së, dhe, si pasojë e tij, çështja civile ku kërkuesi është palë vijon të jetë ende në shqyrtim në gjykatën e shkallës së parë prej më shumë se 3 vjetësh, Gjykata, për të vlerësuar nëse kjo kohëzgjatje ka qenë e arsyeshme dhe për të arritur në përfundimin nëse kërkuesit i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt në këtë aspekt, duhet të ndalet në vlerësimin e këtyre kritereve: (i) sjelljes së kërkuesit; (ii) kompleksitetit të çështjes; (iii) sjelljes së autoriteteve; (iv) rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022; nr. 34, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

i. Sjellja e kërkuesit

32. Sipas jurisprudencës kushtetuese vlerësimi i sjelljes së kërkuesit është një element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke u analizuar rrethanat nëse ai ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të, dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në rastin konkret kërkuesi është pala që ka vënë në lëvizje procedimin penal dhe për këtë shkak, mbi kërkesën e palës kundërshtare në procesin gjyqësor civil, është vendosur edhe pezullimi i këtij të fundit deri në përfundimin e çështjes penale, ndërkohë që gjykata më e lartë nuk e ka pranuar kundërshtimin e tij për këtë pezullim. Në pritje të përfundimit të hetimeve penale kërkuesi i është drejtuar prokurorisë me kërkesë për informacion dhe më pas i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit

të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedimit penal. Kërkuesi, ashtu si edhe paditësit e tjerë në procesin gjyqësor, të cilët në atë gjykim përfaqësohen prej tij, rezultojnë të kenë vepruar në përputhje me të drejtat e tyre procedurale dhe nuk rezultojnë të kenë shkaktuar vonesa apo të jenë bërë shkak për vonesat në procedurat penale apo edhe ato civile.

ii. Kompleksiteti i çështjes

34. Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e kompleksitetit të çështjes marrin rëndësi të gjitha aspektet e saj, përfshirë objektin, faktet e kundërshtuara, volumin dhe natyrën e provave, llojin dhe ndërthurjen e ligjeve të zbatueshme, si dhe numrin e palëve pjesëmarrëse në proces. Kohëzgjatja e konsiderueshme e gjyimit mund të justifikohet nga kompleksiteti i çështjes, pasi balancohet nga parimi i administrimit të përshtatshëm të drejtësisë (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 13, datë 26.05.2022; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Në rastin konkret rezultojnë se procedimi penal është regjistruar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i KP-së, në lidhje me dy akte shkresore të paraqitura si prova nga pala kundërshtare e kërkuesit (pala e paditur) në gjykimin civil. Nga aktet e administruara nga Gjykata, në mungesë të informacionit nga Prokuroria e Korçës, nuk konstatohet që hetimi i procedimit penal të regjistruar të shfaqë ndonjë kompleksitet që të justifikojë kohëzgjatjen e tij, në rrethanat kur, për sa i është bërë e ditur Gjykatës, bëhet fjalë për verifikimin e pretendimit për falsitet të dy akteve shkresore në fjalë, të hartuara në një kontekst të caktuar rrethanash.

iii. Sjellja e autoriteteve

36. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjyimit brenda afatit të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese, e cila nuk kufizohet vetëm në procesin gjyqësor, çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij kushtetuese e ligjore, është i detyruar të respektojë standardet e procesit të rregullt (*shih vendimet nr. 23, datë 10.10.2022; nr. 25, datë 10.5.2021; nr. 29, datë 27.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).



37. Gjykata vëren se Prokuroria e Korçës, si organi kompetent për zhvillimin e hetimeve të procedimit penal të regjistruar mbi bazën e kallëzimit të kërkuarit, nuk ka paraqitur prapësime në lidhje me pretendimet e kërkuarit dhe as parashtrime në drejtim të pasqyrimin të shkaqeve që kanë çuar në mospërfundimin e hetimeve apo nëse ka pasur ndonjë vendim për kohëzgjatjen e tyre dhe stadin në të cilin ndodhen ato. Ky organ është mjaftuar vetëm me informacionin e dërguar më datë 26.1.2024, ku është shprehur se çështja penale është ende në hetim.

38. Gjykata mban në vëmendje edhe procesin gjyqësor civil në të cilin kërkuari ka cilësinë e paditësit. Në këtë proces, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur pezullimin e tij bazuar në nenin 297, shkronja “a”, të KPC-së, deri në përfundimin e çështjes penale që i përket procedimit penal nr. 102 të vitit 2021, me arsyetimin se procedimi penal i regjistruar mbi kallëzimin e kërkuarit ka lidhje me gjykimin e çështjes civile për sa kohë që bëhet fjalë për të njëjtat akte shkresore që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me pasurinë trashëgimore objekt padie, të paraqitura si prova në gjykimin civil nga pala e paditur dhe për të cilat kërkuari pretendon se janë të falsifikuara, fakt ky që, nga ana tjetër, përbën edhe bazën e kallëzimit penal mbi të cilin është regjistruar procedimi penal. Nga sa vërehet, megjithëse dispozita mbi të cilën gjykata ka bazuar vendimin e saj si shkak pezullimi të gjykimit përcakton pamundësinë e zgjidhjes së çështjes civile para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative, ajo çka është konsideruar nga gjykata është thjesht dhe vetëm lidhja mes çështjes civile dhe asaj penale në pikëpamje të objektit të të provuarit. Ndërkohë të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe gjykata më e lartë në përgjigje të ankimit të kërkuarit, çka ka sjellë ndërprerjen e procesit civil dhe mundësinë e aktivizimit të tij vetëm pas përfundimit të procedimit penal.

39. Gjykata konstaton se kërkuari, megjithëse për të drejtën subjektive të pretenduar ka kërkuar mbrojtje civile dhe penale, ende nuk ka një përgjigje nga ana e autoriteteve tashmë prej më shumë se 3 vjetësh, ndërkohë që për shkak të mbivendosjes nga ato të këtyre proceseve dhe etapave që kalon procedimi penal, edhe perspektiva në vijim nuk duket shpresëdhënëse në pikëpamje të afërsisë kohore kur kërkuari, në procesin civil, do të ketë një

përgjigje përfundimtare për të drejtën subjektive të pretenduar.

40. Për sa i përket Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, që ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit për konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt dhe përshpejtimin e procedurave, ajo ka vlerësuar se kërkuari ndodhet në pozitën e viktimës të parashikuar nga neni 58 i KPP-së, por ai nuk është palë në procesin penal në pozita të njëjta me prokurorin ose të pandehurin, për rrjedhojë nuk mund të ketë legjitimim për të ushtruar të njëjtat të drejta që ligjvënësi ua ka rezervuar këtyre palëve, përfshirë edhe të drejtën e ankimit kundër vendimit të gjykatës që ka gjykuar çështjen në themel. Sipas asaj gjykate, kërkuari nuk rezulton të jetë palë në një proces civil apo të ketë paraqitur padi civile në një proces penal dhe nuk rezulton të jetë personi ndaj të cilit zhvillohet hetim penal apo gjykohet akuzë, por është në cilësinë e kallëzuesit/viktimës së veprës penale në një çështje që ndodhet në fazën e hetimit, për rrjedhojë ai nuk përfshihet në parashikimet e nenit 6 të KEDNJ-së, për të cilin duhet të garantohet e drejta për proces të rregullt, në elementin e përfundimit të hetimeve apo gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar, gjithashtu, se në zbatim të neneve 9/a dhe 58 të KPP-së nuk rezulton të parashikohet e drejta e viktimës së veprës penale për hetimin apo gjykimin e çështjes penale brenda një afati të arsyeshëm (*shih faqet 5 dhe 6 të vendimit nr. 41-2022-3777 (53 prot.), datë 14.12.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë*).

41. Gjykata vëren se sipas nenit 399/1 të KPC-së, në kompetencë të gjykatave, sipas shkallëve të gjykimit, hyn edhe shqyrtimi i kërkesave për shpërblimin e drejtë të personit që ka pësuar një dëm pasuror ose jopasuror për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes, sipas përkufizimit të nenit 6/1 të KEDNJ-së. Dispozitat vijuese përcaktojnë vlerësimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, si edhe shpërblimin e drejtë, kur konstatohet kohëzgjatje e paarsyeshme në procedurat e hetimit, gjykimit të çështjeve, si edhe në procedurat e ekzekutimit të vendimeve. Në kuptim të këtyre parashikimeve, kërkuari i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë, si gjykata kompetente, për konstatimin e cenimit të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procedimit penal, duke pretenduar se kjo ka sjellë pengesë në ushtrimin e të drejtave juridike civile të tij si palë paditëse në procesin



gjyqësor që është duke u zhvilluar në po atë gjykatë, i cili është i pezulluar në pritje të përfundimit të hetimeve penale.

42. Gjykata vëren se në vlerësimin që i ka bërë kërkesës së kërkuarit gjykata e shkallës së parë i është referuar në arsyetimin e saj përmbajtjes së nenëve 9/a dhe 58 të KPP-së, që parashikojnë të drejtat e viktimës nga vepra penale, mes të cilave: të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit; të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor; të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrijë kërkesa të tjera përpara organit procedues; të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit; të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprahe për të pushuar akuzën ose çështjen; të thirret në seancën paraprahe dhe në seancën e parë gjyqësore etj. Ajo gjykatë i ka njohur kërkuarit pozitën e viktimës në kuptim të nenit 58 të KP-së, çka do të thotë edhe të drejtat gjatë procedimit penal në lidhje me gjendjen në të cilën ndodhet ai, ndërkohë që e ka trajtuar legjitimitimin e tij në drejtim të së drejtës për të paraqitur ankim kundër vendimit që ka shqyrtuar në themel çështjen penale dhe ka vendosur (pa)fajësinë e të pandehurit, çka nuk është rasti konkret. Nga ana tjetër, gjykata është shprehur edhe se kërkuari nuk ka cilësinë e palës në ndonjë proces civil ose penal. Ndërkohë që ajo gjykatë, edhe pse ka cituar dispozitat përkatëse të KPC-së që parashikojnë mjetet juridike dhe procedurat për paraqitjen dhe gjykimin e kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit, nuk e ka analizuar çështjen dhe pretendimet e kërkuarit në drejtim të qëllimit dhe natyrës së këtyre mjeteve juridike. Ajo nuk ka bërë asnjë analizë në drejtim të legjitimitimit të kërkuarit, duke e lidhur me të drejtat që vihen në diskutim dhe dëmin që mund t'i ketë ardhur atij në të drejtat ligjore që kërkon të mbrojë përmes kërkesës për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave penale. Për rrjedhojë, mungesa e analizës për sa më sipër, si dhe vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë se për kërkuarin nuk garantohej e drejta për proces të rregullt në drejtim të përfundimit të hetimeve dhe gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, vënë në dyshim edhe standardin e arsyetimit të atij vendimi.

43. Për sa më sipër, në lidhje me sjelljen e autoriteteve, vlerësohet se ajo nuk ka qenë sjellja e duhur që kërkon e drejta për proces të rregullt dhe është bërë shkak për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procedimeve.

iv. Rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuari

44. Kriteri i interesit të kërkuarit dhe rëndësisë së asaj që ai rrezikon nga tejzgjatja e procedurave përbën një aspekt tjetër të rëndësishëm të vlerësimit të kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit (*shih vendimin nr. 46, datë 03.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata vëren se pretendimet e kërkuarit, në thelb, kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e procesit civil për njohjen dhe kthimin e pasurisë trashëgimore, i cili është pezulluar në pritje të përfundimit të hetimeve penale në kuadër të procedimit penal të vënë në lëvizje po mbi bazën e kallëzimit të kërkuarit, për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve të paraqitura si provë në atë gjykim nga pala e paditur.

45. Kërkuari, përmes procesit civil vënë në lëvizje në gjykatën e shkallës së parë, ka kërkuar mbrojtjen e së drejtës së pronës private për pasurinë e pretenduar se rrjedh nga trashëgimia. Ai, si palë paditëse në procesin gjyqësor civil, është ende në pritje të rifillimit të shqyrtimit gjyqësor, i cili është i pezulluar që prej vitit 2021 dhe është i ndërruar nga përfundimi i hetimeve dhe rezultati i tyre për falsitetin e disa prej dokumenteve që, si prova të paraqitura nga pala e paditur në drejtim të provueshmërisë së pretendimeve të saj për pasurinë objekt konflikti gjyqësor, do t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes civile mes palëve.

46. Duke pasur parasysh sa më sipër, në kushtet kur çështja civile ku kërkuari është palë dhe përmes së cilës ai kërkon mbrojtjen e së drejtës së pronës është e pezulluar nga gjykata deri në përfundimin e çështjes penale të vënë në lëvizje po prej kërkuarit, kohëzgjatja e hetimeve nga ana e Prokurorisë së Korçës dhe kohëzgjatja tërësore e procedurave merr rëndësi në drejtim të asaj që rrezikon ai qoftë si viktimë e veprës penale, ashtu edhe si palë në procesin gjyqësor civil. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata, për shkak të natyrës së çështjes dhe efekteve që ajo ka në gjykimin civil ku kërkuari është palë, çmon se kjo çështje duhet të shqyrtohet me prioritet nga ana e prokurorisë.

47. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për



proces të rregullt, në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit dhe përshpejtimit të procedurave, është i bazuar, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 41-2022-3777 (53 prot.), datë 14.12.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
 3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm për shkak të mospërfundimit të hetimeve.
 4. Detyrimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për përfundimin e hetimeve me prioritet.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 15.02.2024

Shpallur më 13.03.2024

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim

VENDIM

Nr. 7, datë 20.2.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;

Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Ilir Toska	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 20.2.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 9 (K) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Klodian Çani

SUBJEKT I INTERESUAR: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-342 (52), datë 13.2.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 49, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari Klodian Çani ka qenë i punësuar në administratën doganore prej vitit 2006, në detyrën e doganierit, marrëdhënie që është ndërprerë në vitin 2012 për shkak të shkurtimit të strukturës. Më pas, në datën 8.1.2014, ai është punësuar në Degën e Doganës Kakavijë dhe prej datës 25.2.2014, është caktuar në detyrën e përgjegjës të turnit në Zyrën Operacionale Doganore të kësaj dege doganore.

2. Në datën 16.3.2015, Drejtoria e Hetimit pranë Departamentit Operativ Hetimor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ka përpiluar një informacion, “Për referimin e veprës penale te prokurori” lidhur me veprimet dhe mosveprimet e datës 26.2.2015, të personelit doganor të Degës së



Doganës Kakavijë, të personelit të antikontrabandës tokësore të Drejtorisë së Antikontrabandës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, si dhe të disa shtetasve. Sipas këtij informacioni, nga hetimi paraprak ka rezultuar se në datën 26.2.2015, në Degën e Doganës Kakavijë kanë qenë në shërbim pesë punonjës, konkretisht përgjegjësi i turnit Klodian Çani, dy doganierë kualifikim/vlerësim/kontroll fizik në pikën e hyrjes, një doganier peshore/pike në parkim dhe një doganier peshore/pikë kontrolli në peshore. Mesditën e kësaj date, në orën 12:21, sipas të dhënave të sistemit TIMS, përmes pikës doganore kufitare Kakavijë kanë hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë dy mjete me targa të identifikuar. Sipas regjistrat të pikës së hyrjes nga Greqia në Shqipëri dhe sipas regjistrat të peshores të zyrës doganore kufitare Kakavijë, mjeti i parë nuk rezulton të jetë regjistruar në regjistrin e hyrjes së mjeteve nga dy doganierët e pikës së hyrjes dhe as të jetë peshuar e regjistruar në regjistrin e peshores nga doganieri i peshores. Po kështu, sipas regjistrat të parkingut doganor të kësaj zyre nuk rezulton që mjeti në fjalë të jetë regjistruar në regjistrin e parkingut doganor nga doganieri përkatës. Nga këqyrja e pamjeve filmike të kamerave të kësaj zyre doganore ka rezultuar se ky mjet nuk është peshuar dhe ka dalë nga parkingu për më pak se 2 minuta, në orën 12:38. Pjesë e këtij informacioni kanë qenë edhe të dhënat për mjetin tjetër, i cili, njëlloj si i pari, nuk është regjistruar dhe peshuar në regjistrat e peshores dhe parkingut, duke dalë prej tij në të njëjtën orë dhe pa iu nënshtruar procedurave të zhdoganimit. Po kështu, sipas informacionit, referuar dokumentacionit të ndodhur në doganën greke të Kakavijës, dy mjetet në fjalë kanë qenë të ngarkuara, ndërkohë që për të vërtetuar llojin dhe vlerën e mallit të eksportuar në datën 11.3.2015, u është kërkuar autoriteteve greke dokumentacioni që ato disponojnë për veprimet doganore të kryera për mallin e ngarkuar në këto mjete.

3. Mbi bazën e informacionit të Drejtorisë së Hetimit pranë Departamentit Operativ Hetimor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka regjistruar procedimet penale nr. 124 dhe 125 të vitit 2015, për veprat penale “Kontrabanda me mallra të tjerë” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 174 dhe 248 të Kodit Penal (KP). Me vendimin e datës 8.5.2015, prokurori, duke qenë se hetimet u zhvilluan në ngarkim të të njëjtëve shtetas,

dy doganierëve të peshores, të dyshuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe shtetasit B. F., i dyshuar për veprën penale “Kontrabanda me mallra të tjerë”, ka vendosur bashkimin e procedimeve penale në një të vetëm me nr. 124, të vitit 2015. Në kuadër të hetimeve është pyetur si person që ka dijeni për veprën penale edhe kërkuesi Klodian Çani, i cili ka deklaruar se nuk ka qenë në dijeni të kalimit të mjeteve dhe se nuk është njoftuar nga ndonjë doganier. Në përfundim të hetimeve, me vendimin e datës 11.5.2015, në mbështetje të nenit 328, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Penale (KPP), prokurori ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të dy doganierëve të peshores dhe të shtetasit B.F., pasi nga tërësia e të dhënave të marra gjatë veprimeve hetimore, në mungesë të verifikimit të fakteve të ndodhura në shtetin grek dhe të konfirmimit të vërtetësisë së tyre, nuk mund të vërtetohej kryerja e veprave penale.

4. Ndërkohë, informacioni i Drejtorisë së Hetimit pranë Departamentit Operativ Hetimor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave i është dërguar edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, duke u trajtuar administrativisht nga Komisioni Disiplinor pranë kësaj Drejtorie (*Komisioni Disiplinor*). Fillimisht, me vendimin nr. 6186/7, datë 16.3.2015, Komisioni Disiplinor ka vendosur pezullimin nga detyra të kërkuesit Klodian Çani. Më pas, bazuar në nenet 57, pika 2, shkronja “a” dhe 60, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar (*ligji nr. 152/2013*), me vendimin nr. 12437/22, datë 12.6.2015, Komisioni Disiplinor ka vendosur marrjen e masës disiplinore “Largim nga Shërbimi Civil” ndaj kërkuesit Klodian Çani. Sipas Komisionit Disiplinor, ky rast ngarkonte me përgjegjësi të drejtpërdrejtë, përveçse të gjithë punonjësit e turnit, edhe përgjegjësin e zyrës, i cili ndër detyrat funksionale ka edhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së nëpunësve në varësi. Komisioni ka vlerësuar se me veprimet dhe mosveprimet e tij kërkuesi është përgjegjës për shkeljen me faj të detyrimeve të nëpunësve, konkretisht ai ndodhet në mospërmbushje të rëndë të detyrave, pasi është përgjegjës për lejimin e daljes së mjeteve nga territori doganor pa paguar ose garantuar detyrimet doganore që duheshin paguar.

5. Kërkuesi, duke mos qenë dakord me vendimin e Komisionit Disiplinor, i është drejtuar gjykatës administrative me padi për shfuqizimin e tij,



rikthimin në punë, si dhe pagimin e pagës nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës.

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 4483, datë 16.9.2015, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, duke shfuqizuar vendimin nr. 12437/22, datë 12.6.2015 të Komisionit Disiplinor dhe detyruar Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të kthente paditësin (kërkuesin) në vendin e mëparshëm të punës, si dhe t'i paguante pagën nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në kthimin në detyrë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur në procesin gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë.

7. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2556, datë 27.11.2015, në dhomën e këshillimit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 4483, datë 16.9.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, që ka kërkuar ndryshimin e vendimeve të mësipërme të gjykatave dhe rrëzimin e padisë.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-342 (52), datë 13.2.2023, në dhomën e këshillimit, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe rrëzimin e padisë.

9. Në datën 11.5.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të mësipërm. Me vendimin e datës 18.7.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. Kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë i ka cenuar:

10.1 Të drejtën për proces të rregullt në drejtëm të *standardit të gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Kolegji Administrativ i ka analizuar ndryshe nga gjykatat më të ulëta rrethanat dhe faktet e çështjes, duke vlerësuar se veprimet e palës së paditur janë marrë në zbatim të drejtë të ligjit. Ai është mjaftuar me

referencën ligjore të zgjidhjes së çështjes, pa dhënë kuptimin dhe zbatimin e ligjit material në raport me ndonjë detyrim konkret të kontratës së punës së shkelur nga kërkuesi dhe ndonjë element konkret në të cilin është mbështetur për përcaktimin e shkeljes së kryer me faj të rëndë dhe/ose pasojave të ardhura nga veprimet e tij. Gjykata e Lartë ka shqyrtuar dhe vendosur për çështje fakti që nuk janë në kompetencë të saj. Ndonëse funksioni i saj është gjykatë ligji, ajo ka ndryshuar vendimet e gjykatave të faktit dhe është shprehur për themelin e çështjes, duke bërë vlerësim të ndryshëm të provave dhe fakteve të administruara gjatë gjykimit në gjykatat më të ulëta. Ajo gjykatë ka nxjerrë konkluzion për provat në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave më të ulëta dhe ka rivlerësuar provat e administruara dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, duke arritur në një përfundim të ndryshëm. Kolegji Administrativ e ka vlerësuar të drejtë vendimin e palës së paditur, duke u bazuar vetëm në vlerësimin e bërë për procedimin penal nr. 124 të vitit 2015, të filluar dhe më pas të pushuar nga prokuroria.

10.2 Të drejtën për punë, të sanksionuar në nenin 49 të Kushtetutës, pasi veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale përbën cenim të saj.

11. Subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

11.1 Në lidhje me legjitimitimin e kërkuesit, në drejtëm të kriterit të shterimit të mjeteve juridike, pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt është ngritur rishtazi në ankimin kushtetues dhe kërkuesi nuk ka paraqitur argumente kushtetuese konkrete dhe të mjaftueshme që ta mbështesin atë, ndaj nuk duhet të merret në shqyrtim nga Gjykata.

11.2 Në lidhje me themelin e çështjes, pretendimi për të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është i pabazuar, pasi vendimmarrja e Gjykatës së Lartë është në përputhje me natyrën e gjykimit që kryen ajo në ushtrim të funksionit të kontrollit të zbatimit të drejtë të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Kolegji Administrativ është mbështetur në të njëjtat fakte dhe prova të vlerësuar nga gjykatat e faktit, duke arritur në përfundimin se në rastin konkret është bërë një interpretim i gabuar i ligjit dhe një cilësim jo i saktë i rrethanave të faktit, për rrjedhojë çështja nuk është zgjidhur në përputhje me



dispozitat procedurale dhe materiale në zbatim. Ai nuk ka marrë prova të reja dhe nuk ka bërë një gjykim të ri, por ka hedhur dritë mbi mënyrën se si gjykatat më të ulëta kanë zbatuar ligjin.

11.3 Edhe pretendimi për cenimin e nenit 49 të Kushtetutës është i pabazuar. Kjo dispozitë parashikon të drejtën për punësim, por mes punëdhënësit dhe punëmarrësit ka të drejta dhe detyrime që duhet të zbatohen. Penalizimi dhe marrja e masës disiplinore për kërkuesin ka ardhur si pasojë e mospërmbushjes së detyrave funksionale, shkelje që është konsideruar e rëndë. Punëdhënësi ka plotësuar të gjitha detyrimet e tij dhe ka respektuar të drejtat e punëmarrësit dhe ky i fundit nuk ka pasur asnjë ankesë, gjatë kohës që ka qenë në detyrë, për shkeljen e kushteve të punës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Gjykata çmon se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “P” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “I”, të pikës 1, të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

14. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin

gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

15. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 13.2.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 11.5.2023, pra brenda afatit 4-mujor.

16. Për sa i takon legjitimitit *ratione materiae* kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për punë, të parashikuar në nenin 49 të Kushtetutës, duke pretenduar se veprimet e organeve shtetërore kanë sjellë pasoja të drejtpërdrejta edhe në drejtim të ushtrimit të veprimtarisë profesionale të tij, duke penguar atë. Gjykata vëren se sipas nenit 49 të Kushtetutës secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë, si dhe është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit profesional. Në këtë kuptim, vetëm dhënia e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil” për kërkuesin nuk është e mjaftueshme në nivel kushtetues për të kërkuar mbrojtjen që ofron neni 49 i Kushtetutës, për sa kohë kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë se nëpërmjet akteve të kundërshtuara i është ndaluar aksesin në çdo profesion ose veprimtari tjetër profesionale. Për rrjedhojë, në lidhje me këtë pretendim kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae*.

17. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, si element i së drejtës për proces të rregullt, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, për shkak se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka zgjidhur çështjen duke vlerësuar në mënyrë të ndryshme provat e administruara nga gjykatat e faktit. Ky pretendim, për nga natyra e tij, hyn në juridiksionin kushtetues, prandaj Gjykata, në vijim, do të shqyrtojë bazueshmërinë e tij në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj

18. Sipas kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka analizuar ndryshe nga gjykatat më të ulëta rrethanat dhe faktet e çështjes, duke vlerësuar se veprimet e palës së paditur janë marrë në zbatim të drejtë të ligjit dhe duke u mjaftuar me



referencën ligjore të zgjidhjes së çështjes, pa dhënë kuptimin dhe zbatimin e ligjit material në raport me ndonjë detyrim konkret të kontratës së punës së shkëlur prej tij. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Administrativ ka shqyrtuar dhe vendosur për çështje fakti që nuk janë në kompetencë të tij dhe është shprehur për themelin e çështjes mbi vlerësim të ndryshëm të provave dhe fakteve të administruara gjatë gjykimit në gjykatat më të ulëta, duke nxjerrë konkluzion për provat në të kundërt me vlerësimin e gjykatave të faktit dhe duke vlerësuar të drejtë vendimin e palës së paditur mbi bazën vetëm të vlerësimit të bërë për procedimin penal nr. 124, të vitit 2015 të filluar dhe më pas të pushuar nga prokuroria.

19. Subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ka prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në përputhje me funksionin e tij, është mbështetur në të njëjtat fakte dhe prova të vlerësuara nga gjykatat e faktit, duke vlerësuar se në rastin konkret është bërë një interpretim i gabuar i ligjit dhe nuk është bërë një cilësim i saktë i rrethanave të faktit, për rrjedhojë çështja nuk është zgjidhur në përputhje me dispozitat procedurale dhe materiale në zbatim. Sipas këtij subjekti, Kolegji Administrativ nuk ka marrë prova të reja dhe nuk ka bërë një gjykim të ri, por ka hedhur dritë mbi mënyrën se si gjykatat më të ulëta kanë zbatuar ligjin.

20. Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj. Ndërsa në nenin 141, pika 1, parashikohet se Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit.

21. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një *“gjykatë e caktuar me ligj”*. Ky element, në sensin material, karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale

për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 3, datë 7.2.2023; nr. 7, datë 23.2.2021; nr. 27, datë 24.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Po kështu, Gjykata ka theksuar se Gjykata e Lartë, në funksionin e saj si gjykatë e ligjit, nuk mund të ndryshojë vendimet e gjykatave të faktit dhe të shprehet për themelin e çështjes, duke bërë vlerësim të ndryshëm të provave dhe fakteve që janë administruar gjatë gjykimit nga gjykatat më të ulëta. Procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë të vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë ose të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar gjatë gjykimit në fakt (*shih vendimet nr. 15, datë 23.3.2023; nr. 10, datë 3.4.2018; nr. 20, datë 20.3.2017; të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata është shprehur se nxjerrja e konkluzionit për provat në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave të shkallëve më të ulëta nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta rezulton e provuar e kundërta. Nëse Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit, por në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta



gjyqësore. Një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj (*shih vendimet nr. 15, datë 23.3.2023; nr. 44, datë 19.7.2016; nr. 36, datë 30.6.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata vëren se në lidhje me procedimin disiplinor Komisioni Disiplinor, me vendimin nr. 12437/22, datë 12.6.2015, bazuar në përmbajtjen e neneve 57, pika 2, shkronja “a” dhe 60 të ligjit nr. 152/2013, ka vendosur marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil” ndaj kërkuesit. Sipas tij ky rast ngarkon me përgjegjësi të drejtpërdrejtë përveçse të gjithë punonjësit e turnit, edhe përgjegjësin e zyrës, i cili ndër detyrat funksionale ka edhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së nëpunësve në varësi. Komisioni Disiplinor ka vlerësuar se nëse kërkuesi do të kryente detyrën funksionale duke kontrolluar edhe punën e grupit, do të kishte parandaluar në linjën zinxhir veprimet e paligjshme ose shkeljet e kryera hap pas hapi, duke mos u lejuar kalimi i dy mjeteve me ngarkesë pa kryer procedurat doganore. Sipas komisionit, me veprimet dhe mosveprimet e tij kërkuesi është përgjegjës për shkelje me faj të detyrimeve të nëpunësve, konkretisht ai ndodhet në mospërmbushje të rëndë të detyrave, pasi është përgjegjës për lejimin e daljes së mjeteve nga territori doganor pa paguar ose garantuar detyrimet doganore që duheshin paguar. Për rrjedhojë, Komisioni Disiplinor ka vlerësuar se ndaj kërkuesit rëndon përgjegjësia për shkelje me faj të detyrimeve që përcakton neni 250 i Kodit Doganor, pasi ai nuk ka kryer detyrat funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, si dhe nuk ka respektuar urdhrat e drejtorit të përgjithshëm të Doganave (*shih faqen 5 të vendimit të Komisionit Disiplinor*).

25. Duke mos qenë dakord me vendimin për dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, kërkuesi ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor të kundërshtuar. Për sa i përket gjykimit të çështjes në shkallë të parë, në funksion të vërtetimit të faktit disiplinor, pra të bazueshmërisë faktike të vendimit për dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, pala e paditur ka paraqitur si provë informacionin e datës 16.3.2015 të Drejtorisë së Hetimit pranë Departamentit Operativ Hetimor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Në përgjigje të kësaj, kërkuesi ka paraqitur si provë vendimin e prokurorit të datës 11.5.2015, për pushimin e hetimeve në ngarkim të dy doganierëve të peshores dhe të shtetasit B.F. Në përfundim të

gjykimit, gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, duke shfuqizuar vendimin e mësipërm të Komisionit Disiplinor dhe detyruar palën e paditur ta kthejë kërkuesin në vendin e mëparshëm të punës, si dhe t'i paguajë pagën nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në kthimin në detyrë.

26. Në vlerësimin e asaj gjykate, në analizë të fakteve që lidhen me ngjarjen e datës 26.2.2015, në Degën e Doganës Kakavijë, në asnjë moment ose episod nuk provohet që paditësi (kërkuesi) të ketë kryer shkelje ose shkelje të rëndë të detyrave të tij funksionale. Po sipas saj, me asnjë provë nuk vërtetohet se mjetet që kanë kaluar në atë pikë doganore kanë kryer kontrabandë, e cila është një hipotezë që nuk është provuar nga asnjë prej autoriteteve ligjzbatuese, ndaj kërkuesi nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi disiplinore, sepse nuk ka parashikuar ndodhjen e një fakti që nuk ekziston. Sipas gjykatës së shkallës së parë, përfundimi i arritur nga Komisioni Disiplinor lidhur me vendimin e datës 11.05.2015 të prokurorisë, duke nënkuptuar se pushimi ka ndodhur në pritje të përgjigjeve të letërporosive nga autoritetet greke dhe se për kërkuesin hetimet vazhdojnë, është i pabazuar, pasi prokuroria nuk ka filluar asnjëherë procedim penal ndaj tij, sepse nuk ka konstatuar që ai ka ndonjë përgjegjësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për situatën e paprovuar dhe se procedimi penal nr. 124 i vitit 2015 është pushuar pasi nuk mund të vërtetohej kryerja e veprave penale. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar më tej se Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të identifikojë qartë shkeljen shumë të rëndë disiplinore të kryer nga paditësi (kërkuesi), nuk ka arritur ta faktojë dhe provojë ekzistencën e saj dhe të pasojës shumë të rëndë që ka sjellë. Sipas asaj gjykate, në dhënien e masës disiplinore komisioni nuk ka respektuar nenin 60, të ligjit nr. 152/2013, për sa i përket parimit të proporcionalitetit në lidhje me përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore, për sa kohë nuk ka bërë asnjë analizë të shkaqeve dhe rrethanave të shkeljes disiplinore, pasojave të saj dhe shkallës së fajësisë së kërkuesit (*shih faqet 12 dhe 13, të vendimit nr. 4483, datë 16.9.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*).

27. Gjykata e apelit, pas shqyrtimit në dhomën e këshillimit mbi bazë dokumentesh të ankimit të paraqitur nga pala e paditur, ka përligjur qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar se



pretendimet e palës së paditur se ndodhej para një fakti të dënueshëm penalisht, nuk janë atribut i vlerësimit në këtë gjykim administrativ, edhe për faktin se ecuria disiplinore dhe masa disiplinore nuk rezultojnë të jenë rrjedhojë e përfundimeve të natyrës penale. Ajo ka gjetur të drejtë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se për sa kohë nuk provohet të jetë kryer kontrabandë ose shpërdorim detyre nga doganierët, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi disiplinore paditësi (kërkuesi). Sipas gjykatës së apelit, qëndrimi i palës së paditur se nëse kërkuesi do të kryente detyrën e tij funksionale do të kishte parandaluar në linjën zinxhir veprimet e paligjshme ose shkeljet e kryera hap pas hapi, nuk mbështet cilësime për shkelje shumë të rëndë sipas nenit 57, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 152/2013. Rrethanat e parashtruara dhe të rezultuara në gjykim nuk mbështesin vlerësimin se jemi para shkeljes shumë të rëndë dhe pala e paditur nuk ka argumentuar kategorizimin e shkeljes referuar elementeve që parashikon neni 60 i po këtij ligji (*shih faqet 9 dhe 10, të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*).

28. Ndërsa Gjykata e Lartë, në ndryshim nga gjykatat e faktit, ka vlerësuar se organi publik nuk ka vendosur të largojë nga detyra kërkuesin për shkak se ka filluar procedimi penal në ngarkim të vartësve të tij, por sepse ai ka kryer veprime dhe mosveprime që përbëjnë mospërmbushje të rëndë të detyrës së përgjegjësit të ruajtjes dhe kontrollit të veprimtarisë së ushtruar nga vartësit e tij. Sipas Kolegjit Administrativ, gjykatat administrative kanë zbatuar në mënyrë të gabuar kriteret e vlerësimit të përgjegjësisë individuale në rastin e procedimit disiplinor me ato të procedimit penal dhe nuk kanë interpretuar dhe zbatuar drejt dispozitat e KPP-së që rregullojnë raportin juridik mes dy proceseve. Kjo sepse, referuar nenit 70 të KPP-së, vetëm vendimi gjyqësor penal i fajësisë ka efektin e gjësë së gjykuar dhe efektin detyrues jashtë procesit penal me karakter *erga omnes*, ndërsa vendimi i pushimit të çështjes penale ose vendimi gjyqësor i pafajësisë, sipas neneve 387 dhe 388 të KPP-së, nuk ka efekt detyrues në gjykimin civil ose administrativ. Kolegji Administrativ ka vlerësuar se konkluzionet e arritura në vendimin e pushimit të procedimit penal në lidhje me (mos)vërtetimet e faktit nuk kanë qenë detyruese për gjykatën që shqyrton veprimtarinë e organit publik, aq më tepër kur hetimet në këtë rast janë pushuar në pritje të letërporosisë dërguar

autoriteteve greke. Po sipas këtij Kolegji, vendimi i pushimit të procedimit penal nuk ka zgjidhur pasojat e faktit penal që lidhen me çështjen administrative dhe se pushimi i procedimit penal ndaj vartësve të kërkuesit nuk zgjidh asnjë situatë për përjashtimin e tij nga përgjegjësia administrative. Për më tepër, vendimi i pushimit të procedimit penal është prishur me vendimin e datës 23.9.2015, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, e cila ka urdhëruar vazhdimin e hetimeve, rrethanë dhe situatë faktike kjo që gjithsesi ka ndodhur më pas në kohë nga vendimarrja e organit publik. Në përfundim, sipas Kolegjit Administrativ, ka rezultuar ligjshmëria e veprimit administrativ të dhënies së masës disiplinore për largimin nga puna të paditësit (kërkuesit) bazuar në situatën faktike dhe ligjore në të cilën ka vepruar organi publik, ndaj padia duhet të rrëzohet (*shih paragrafët 25 dhe 27–31, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

29. Në kuptim të standardit të gjykatës së caktuar me ligj, siç është theksuar më sipër, Gjykata thekson se Gjykata e Lartë nuk mund të bëjë ripërcaktim të fakteve bazuar në një vlerësim të ndryshëm të provave të shqyrtuara dhe të vlerësuara nga gjykatat më të ulëta, por mundet që faktin e përcaktuar nga të njëjtat prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit, ta cilësojë juridikisht ndryshe dhe të zgjidhë vetë çështjen në rast se konstaton zbatim të gabuar të ligjit prej tij. Duke verifikuar zbatimin e këtyre standardeve në rastin konkret, rezulton se Gjykata e Lartë ka marrë në analizë vendimin e pushimit të çështjes penale nga prokurori dhe efektet e tij për gjykatën që ka shqyrtuar veprimtarinë e organit publik, për sa kohë që, sipas atij Kolegji, vendimi i prokurorit nuk ka zgjidhur pasojat e faktit penal për përjashtimin e përgjegjësisë administrative të kërkuesit. Pavarësisht kësaj, sipas Kolegjit Administrativ, për shkak të ankimit të vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal, ky vendim është prishur nga gjykata, e cila ka urdhëruar vazhdimin e hetimeve, duke iu referuar për këtë vendimeve gjyqësore të cilat, megjithatë, duke qenë të mëvonshme në kohë, nuk kanë qenë pjesë e shqyrtimit nga gjykatat më të ulëta.

30. Për sa më lart, Gjykata vëren se vlerësimin e tij se veprimet e kërkuesit përbëjnë shkelje të rëndë të detyrave të tij funksionale, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka lidhur me efektin që ka në procesin administrativ vendimi i prokurorit për pushimin e procedimit penal, ndërkohë që gjykatat e faktit, edhe pse i janë referuar kësaj prove



shkresore në vendimet e tyre, e kanë lidhur atë me mungesën e të provuarit të faktit disiplinor dhe të pasojave të ardhura në atë rast, duke mbajtur në vëmendje se barra e provës në këtë drejtim rëndon mbi organin publik punëdhënës. Nga ana tjetër, ky vlerësim i gjykatave të faktit është bërë në funksion të analizimit të vendimit të Komisionit Disiplinor, qoftë në drejtim të të provuarit të faktit të klasifikuar më tej nga ai komision si shkelje disiplinore për kërkuesin, ashtu edhe në drejtim të ligjshmërisë të masës disiplinore të vendosur ndaj tij në raport me atë shkelje disiplinore të atribuuar atij në pikëpamje të proporcionalitetit në aspektin e përshkallëzimit dhe individualizimit të masës disiplinore. Kolegji Administrativ është shprehur se gjykatat e faktit nuk kanë interpretuar dhe zbatuar drejt dispozitat e KPP-së, por nuk ka evidentuar ndonjë fakt të pranuar si të provuar nga ato dhe, më tej, të ketë dhënë kuptimin për interpretimin dhe zbatimin e ligjit material në raport me ndonjë detyrim kontraktual konkret të shkelur nga kërkuesi, si dhe ndonjë element konkret në të cilin është mbështetur në arritjen e përfundimit për shkallën e rëndesës së shkeljes dhe të pasojës së ardhur nga veprimet ose mosveprimet e vlerësuara si të tilla, pavarësisht se largimi nga shërbimi civil ose ndërprerja e menjëhershme e kontratës së shërbimit publik është masa më e ashpër dhe, si e tillë, në çdo rast duhet parë si alternativa e fundit për t'u përzgjedhur nga organi publik punëdhënës.

31. Në analizë të sa më sipër dhe referuar standardit të gjykatës së caktuar me ligj, Gjykata arrin në përfundimin se Gjykata e Lartë, gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar, ka përcaktuar vetë faktet e çështjes në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkuesit dhe pasojat e veprimeve ose mosveprimeve të tij dhe, mbi këtë bazë, ka zgjidhur në themel çështjen, çka do të thotë se ka bërë një vlerësim të ndryshëm të provave nga sa kishin arritur dy gjykatat e faktit, gjë e cila nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në atë gjykatë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit është i bazuar.

32. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është i bazuar, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-342 (52), datë 13.2.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtuashëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 20.2.2024.

Shpallur më 13.3.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim

VENDIM

Nr. 15, datë 8.3.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datat 7.3.2024 dhe 8.3.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 6 (G) 2023 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Gëzim Boçari



SUBJEKTE TË INTERESUARA: Agjencia e Trajtimit të Pronave; Agjencia Shtetërore e Kadastrës; Avokatura e Shtetit

OBJEKTI: Korrigjim në vendimin nr. 46, datë 3.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese, të gabimit të shtypit të emrit për subjektin e shpronësuar E.D., në pikën 40 të tij, dhe shkrimin e plotë të emrave të subjekteve kërkuese në pikën 1 të vendimit.

BAZA LIGJORE: Neni 80 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën e kërkesit, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Gëzim Boçari, më datë 30.1.2023, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë me objekt: “*Konstatimi se vendimi nr. 18, datë 17.11.2022 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka shkelur të drejtën për gjykim brenda afateve ligjore, përvaktuar nga neni 399 i Kodit të Procedurës Civile. Anulimi i vendimit nr. 18, datë 17.11.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Përsheptimi i gjykimit dhe shpërblymi i dëmit të shkaktuar nga zvarritja e gjykimit tej afateve ligjore, e kërkuar me kërkesën e datës 3.10.2022.*”.

2. Me vendimin nr. 46, datë 3.10.2023, Gjykata ka vendosur: “1. *Pranimin pjesërisht të kërkesës. 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 18, datë 17.11.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. 3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. 4. Detyrimin e Gjykatës së Lartë për të gjykuar çështjen gjyqësore nr. 11111-01272-00-2018 akti brenda 6 muajve.*”.

3. Pas publikimit të vendimit dhe njoftimit të tij palëve, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për korrigjimin e paragrafit 40 të vendimit, konkretisht të gabimit të shtypit të emrit për subjektin e shpronësuar E.D., si edhe shkrimin e

plotë të emrave të subjekteve kërkuese në pikën 1 të vendimit.

4. Me vendimin e datës 11.12.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

5. **Kërkuesi** ka pretenduar se në paragrafin 40, rreshti 7, të vendimit nr. 46, datë 3.10.2023 të Gjykatës, emri i subjektit të interesuar është shkruar A.D., ndërkohë që emri i tij në dokumentet e dosjes gjyqësore është E.D. ose Sh.D. (Gj.). Po kështu, sipas tij, në pikën 1 të vendimit, në rubrikën “Rrethanat e çështjes”, emri i subjekteve të interesuara është shkruar korrekt, por me shkurtime, ndërkohë që sugjeron që këto emra, aty ku shkruhen për herë të parë, të jenë të plotë.

6. **Subjektet e interesuara** nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

7. Në rastet kur Gjykata vihet në lëvizje për ndreqjen e gabimit në vendimin e saj, legjitimitimi i kërkesit dhe procedura parashikohen në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000. Sipas kësaj dispozite, Gjykata ka të drejtë, me kërkesë, të ndreqë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në vendim, pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes, brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit. Vendimi i Gjykatës në këto raste publikohet në Fletoren Zyrtare. I njëjti rregull parashikohet edhe në nenin 43 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit kur kërkesa ka të bëjë me një vendim përfundimtar, kompetente për shqyrtimin e saj është Gjykata.

8. Në kuptim të këtyre dispozitave, kërkuesi, si palë pjesëmarrëse në gjykimin për të cilin është dhënë vendimi nr. 46, datë 3.10.2023 i Gjykatës, legjitimohet *ratione personae*. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi është shpallur më datë 1.11.2023, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë më datë 6.11.2023, pra brenda afatit 2-mujor të parashikuar në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000.



9. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, në kuptim të kompetencës lëndore të Gjykatës, vërehet se kërkuesi ka kërkuar korrigjimin e gabimit në paragrafin 40 të vendimit të Gjykatës nr. 46, datë 3.10.2023, në lidhje me inicialet e subjektit të shpronësuar (trashëgimlënësi). Gjykata vëren se referuar rrethanave të çështjes të pasqyruara në vendimin e saj nr. 46, datë 3.10.2023, kërkuesi Gëzim Boçari është një prej trashëgimtarëve të shtetasve E.D. dhe M.D. (Gj.) (shih paragrafin 1 të vendimit nr. 46, datë 3.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese). Ndërkohë, që në paragrafin 40 të atij vendimi, Gjykata është shprehur: “Bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, konstaton se pas vendimit të sipërcituar të GJEDNJ-së, mbi bazën e kërkesës së një prej trashëgimtarëve të familjes Boçari për kthimin e një sipërfaqeje kullotë, tokë bujqësore dhe truall me sipërfaqe 819,917 m², të ndodhur në Jonufër, Vlorë, ZRAKKP-ja, Vlorë, me vendimin nr. 45, datë 11.3.2009, ka vendosur të njohë të drejtën e pronësisë mbi këtë sipërfaqe, të kthejë sipërfaqen e përgjithshme 494,551 m² trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar A.D. dhe M.D. (Gj.), të mos kthejë sipërfaqen 325,366 m², pasi është e zënë, si dhe të njohë të drejtën e kompensimit për sipërfaqen 321,766 m²”. Për rrjedhojë, duke qenë se në këtë paragraf të vendimit është bërë një gabim material në lidhje me inicialet e njërit prej trashëgimtarëve të kërkuetit dhe ndrejca e tij nuk ndryshon thelbin e vendimmarrjes, Gjykata vlerëson se kërkesa duhet të pranohet.

10. Për sa i përket pjesës tjetër të kërkesës, që lidhet me shkrimin e plotë të emrave të trashëgimtarëve të kërkuetit në rubrikën “Rrethanat e çështjes”, ku ato janë shënuar për herë të parë, Gjykata thekson se në praktikën e saj emrat e subjekteve që nuk janë thirrur në gjykim në cilësinë e subjekteve të interesuara, citohen në vendimin përfundimtar jo në mënyrë të plotë, por me initiale. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk ka të bëjë me saktësimin e vendimit dhe, për më tepër, nuk sjell ndonjë pasojë në lidhje me atë vendim, ndaj ai konsiderohet i pabazuar.

11. Në përfundim, paragrafi 40 i vendimit nr. 46, datë 3.10.2023 të Gjykatës saktësohet duke ndrequr inicialet e subjektit të shpronësuar nga “A.D.” në “E.D.”.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Saktësimin e paragrafit 40, të vendimit nr. 46, datë 3.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese, duke ndrequr inicialet e subjektit të shpronësuar nga “A.D.” në “E.D.”.

3. Një kopje e këtij vendimi i bashkohet vendimit përfundimtar nr. 46, datë 3.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 8.3.2024.

Shpallur, më 13.3.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhafertllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim

NJOFTIM

Nr. 3941, datë 13.3.2024

**MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË
MARRËVESHJEJE DYPALËSHE ME
REPUBLIKËN E BULLGARISË**

Marrëveshja ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë për Mbrojtjen Shoqërore, nënshkruar në distancë, më 15 mars për palën shqiptare dhe më 30 mars 2023 për palën bullgare, do të hyjë në fuqi më datë 1.5.2024.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRIË PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME
Armand Skapi**



VENDIM
Nr. 7, datë 7.3.2024

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË
DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar; në kreun I, nenit 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, të ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”; Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”; i ndryshuar, me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, ‘Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 7, datë 7.3.2024, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega IV, Arka 11, Dosje Drejtimi nr. 650 “Aviacioni”, me 148 (njëqind e dyzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1978–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

2. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega IV, Arka 11, Dosje Drejtimi pa nr. “Industria ushtarake”, me 48 (dyzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1988–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

3. Arkiva e Autoritetit, Fondi Ushtria, Arka 19, Dosje Objekti i rëndësisë së veçantë, Reparti ushtarak Kuçovë nr. 1875, me 2 volume në total 225 (dyqind e njëzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1970–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

4. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega Punëve të Brendshme Fier, Arka 2, Dosje personale dhe pune nr. 3766 “Plepi”, në ngarkim të L.Sh., me 3 volume, në total 280 (dyqind e tetëdhjetë) fletë. Dosja daton

në vitet 1975–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

5. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega Punëve të Brendshme Fier, Arka 3, Dosje personale nr. 7764 “Lundra e re”, në ngarkim të P. F., me 121 (njëqind e njëzet e një) fletë. Dosja daton në vitet 1960–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

6. Arkiva e Autoritetit, Fondi Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, kutia 18, dosje nr. 2, Informacion i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtoria III, me 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

7. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega Punëve të Brendshme Tropojë, Arka 1, Dosje formulare nr. 533 dhe fashikull personal për të dënuar, në ngarkim të U.N., me 97 (nëntëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1955–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

8. Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 4, Dega V, kutia 81, dosje nr. 117. Detyrat orientuese vjetore, si dhe një informacion 3 mujor, 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

9. Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 4, Dega V, kutia 81, dosje nr. 118. Plane masash me raste festash, 13 (trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

10. Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 4, Dega V, kutia 81, dosje nr. 119. Plan pune i degës dhe laboratorit radioteknik i MPB-së, mbi problemet nga analizat e vitit 1978, 8 (tetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

11. Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 4, Dega V, kutia 81, dosje nr. 120. Programe vjetore të përgatitjes profesionale e ushtarake, 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

12. Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 4, Dega V, kutia 81, dosje nr. 121. Urdhër i ministrit mbi blerjen e disa pajisjeve të teknikës jashtë shtetit, 2 (dy) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

13. Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 4, Dega V, kutia 81, dosje nr. 122. Informacion mbi shërbimin e kryer në disa përfaqësi jashtë vendit, 8 (tetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.



14. Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 4, Dega V, kutia 81, dosje nr. 124. Raport mbi luftën kundër shfaqjeve të huaja të cektësisë e globalizmit, për cilësinë në punë, 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

15. Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 4, Dega VI, DSU, kutia 81, dosje nr. 129. Plane masash të degës me rastin e festës, 23 (njëzet e tre) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

16. Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 4, Dega VI, DSU, kutia 81, dosje nr. 134. Informacion për disa shfaqje negative të punëtorit operativ në Fier, F. G., 4 (katër) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

17. Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 4, Dega VI, DSU, kutia 81, dosje nr. 135. Informacion për KQ të PPSH-së mbi veprimtarinë armiqësore e keqbërëse në ushtri gjatë vitit, si dhe mbi aktivitetin armiqësor të ish-ushtarakëve, 23 (njëzet e tre) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

18. Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 4, Dega VI, DSU, kutia 81, dosje nr. 136. Informacione rreth disa kuadrove të marrë në përpunim 2A për agjitacion e propagandë, 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

19. Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 4, Dega VII, MES, kutia 81, dosje nr. 137. Detyrat orientuese vjetore të degës, 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

20. Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 4, Dega VII, MES, kutia 81, dosje nr. 138. Plane masash me raste festash, 4 (katër) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

21. Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 4, Dega VII, MES, kutia 81, dosje nr. 139. Plane masash me rastin e zbërthimit të materialeve të plenumit të 4 të KQ të PPSH-së, 7 (shtatë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

22. Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 4, Dega VII, MES, kutia 81, dosje nr. 140. Detyra që dalin nga zbërthimi i letrës së qeverisë e KQ-së së PPSH-së, dërguar Partisë Komuniste Kineze, 6 (gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

23. Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 4, Dega VII, MES, kutia 81, dosje nr. 141. Temë për ndjekjen e ngjarjeve në bazë të vlerësimit të të dhënave, 24 (njëzet e katër) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

24. Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 4, Dega VII, MES, kutia 81, dosje nr. 142. Raport nga sektorët përkatës të MES-i, Fierza, Fieri e Lushnja, 30 (tridhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

25. Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 4, Dega VII, MES, kutia 81, dosje nr. 143. Informacione mbi tërheqjen në bashkëpunim të disa persona, 152 (njëqind e pesëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitin 1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

